

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA



RREGULLORE DISIPLINORE

Prishtinë, 04 Korrik 2023

Komiteti Ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës duke vepruar në përputhje me Nenin 2, pika c), Nenin 41, pika c) dhe Nenin 62 të Statutit të FFK-së, të miratuar më 27.01.2023, në mbledhjen e vet të mbajtur më 04 Korrik 2023 aprovon:

RREGULORE DISIPLINORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Rregullorja disiplinore e FFK-së, përcakton masat dhe procedurën për ndëshkimin e organizatave themelore dhe profesionale të futbollit, klubeve, anëtarëve dhe shoqatave të tyre, lidhjeve dhe organeve e organizatave tjera të tyre të cilat cenojnë rregullat e lojës së futbollit dhe të sjelljes sportive ose cenojnë statutin dhe aktet tjera normative të FFK-së, ose në çfarëdo mënyrë tjetër cenojnë disiplinën dhe dëmtojnë prestigjin e sportit të futbollit.

Subjektet që udhëheqin me garat e futbollit në rangjet më të ulta, mund të nxjerrin rregulloret e veta disiplinore, dispozitat e të cilave nuk mund të jenë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore, por që të njëjtat mund të zbatohen vetëm në kuadër të garave të rangjeve përkatëse (më të ulta).

I/1. Qëllimi i ndëshkimit

Neni 2

Qëllimi i ndëshkimit disiplinorë është që të ndihmojë në edukimin e drejtë të lojtarëve dhe punëtorëve sportiv dhe të sigurojë zbatimin e drejtë të Rregullave të FFK-së.

I/2. Kundërvajtja me dashje apo nga pakujdesia

Neni 3

Kush bënë kundërvajtje ndaj rregullores disiplinore dhe dispozitave tjera të FFK-së, me dashje apo nga pakujdesia, do të ndëshkohet sipas dispozitave të kësaj rregullore.

I/3. Mosnjohja e dispozitave

Neni 4

Mosnjohja e statutit, rregulloreve dhe dispozitave tjera të FFK-së, nuk e arsyeton askënd. **(inJORIMI I akteve normative të FFK-së, nuk e liron kryesin nga përgjegjësia, por mund të ndikojë në vendosjen e një mase disiplinore më të butë, nëse inJORANCA është e justifikuar).**

I/4. Ndëshkimi i tentimit

Neni 5

Kundërvajtja disiplinore ka mbetur në tentim, kur kryesi me qëllim e ka filluar dhe kryer veprimin, por pasoja e dëmshme nuk është shkaktuar. Tentimi ndëshkohet vetëm për kundërvajtje të cilat parashihen në këtë rregullore. Tentimi ndëshkohet më lehtë se sa kundërvajtja e kryer.

I/5. Cytja dhe ndihma

Neni 6

Kush e cytë ose i ndihmon tjetrit, do të ndëshkohet sikurse ta kishte kryer vetë kundërvajtjen, por që ndihmësi mund të dënohet më butë.

I/6. Subjektet e përgjegjesisë disiplinore

Neni 7

Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen:

- a) Ndaj lojtarëve,
 - b) Ndaj klubeve, ekipeve, funksionarëve dhe anëtarëve të tyre,
 - c) Ndaj udhëheqësëve profesional dhe teknik të klubeve dhe trajnerëve,
 - d) Ndaj udhëheqësive të futbollit dhe funksionarëve të tyre,
 - e) Ndaj gjyqtarëve.
1. Termi, zyrtarë të klubit nënkupton, të gjithë personat që janë nga klubi të regjistruar si përfaqësues zyrtarë të tyre në ndeshje (trajnerë, përfaqësues të klubit, mjekë, fizioterapeutistë, dhe të tjerë).
 2. Termi, zyrtarë të ndeshjes do të thotë; gjyqtarët, asistentët, vëzhguesit e referimit, delegatët e ndeshjes).
 3. Termi, punonjës të futbollit, nëse nuk është shënuar në mënyrë specifike , në kuptojmë të gjithë personat fizik që janë anëtarë të një organizate të futbollit.

I/7. Dënimet (Masat disiplinore)

Neni 8

1. për lojtarë:

- a) vërejtja (**paralajmërimi**),
- b) qortimi,
- c) dënimi me të holla,
- d) ndalesa për të luajtur një kohë të caktuar,
- e) ndalesa për të luajtur numër të caktuar të ndeshjeve kampionale-kupë,
- f) përjashtimi nga klubi,
- g) përjashtimi nga organizata e futbollit.

2. për zyrtarë, udhëheqës profesionalo-teknik dhe trajner:

- a) vërejtja,
- b) qortimi,
- c) dënimi me të holla,
- d) ndalesa e kryerjes së funksionit në kohë të caktuar,
- e) ndalesë e kryerjes së funksionit me numër të caktuar të ndeshjeve,
- f) përjashtimi nga klubi ose udhëheqësia,
- g) përjashtimi nga organizata e futbollit.

3. për udhëheqësitë e organizatave futbollistike:

- a) vërejtja,
- b) qortimi,
- c) ndërrimi nga funksioni,
- d) përjashtimi nga organizata e futbollit.

4. për klube:

- a) vërejtja,
- b) qortimi,
- c) dënimi me të holla,
- d) ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve në terenin e caktuar apo në gjitha terenet e regjionit të caktuar,
- e) zhvillimi i ndeshjeve në teren të vetë pa praninë e shikuesëve,
- f) marrja e pikëve,
- g) pikët negative,
- h) diskualifikimi nga garat,
- i) kthimi në rang më të ulët të garave,
- j) Ndalim i ndeshjeve jashtë vendi,
- k) Ndalim i transferimeve të lojtarëve,
- l) Sekuestrim i licencës për gara evropiane,
- m) Ndalim i pjesëmarrjes në procesin e licencimit për periudhë kohore prej; 1 – 3 vjet,
- n) Sekuestrimi i një titulli apo një çmimi.

5. për kontrollorë të gjyqtarëve, për gjyqtarë dhe vëzhgues të ndeshjes:

- a) vërejtja,
- b) qortimi,
- c) ndalesa e kryerjes së detyrës së kontrollorit të referit, e detyrës së vëzhguesit dhe ndalesa e referimit,
- d) përjashtimi nga organizata e futbollit,
- e) fshirja nga lista e referëve,
- f) Me gjobë në qoftëse marrin kompensim, ndalim referimi me kohë të caktuar, ndalim referimi me numër të ndeshjeve.

I/8 Vërejtja dhe qortimi

Neni 9

Vërejtja dhe qortimi si dënime shqiptohen për kundërvajtje disiplinore të cilat janë kryer nën rrethana lehtësuese, të cilat kundërvajtjen e bëjnë të natyrës së lehtë.

I/9 Dënimi me të holla

Neni 10

Dënimet më të holla – gjordat mund t`iu shqiptohen: klubeve, lojtarëve, trajnerëve, si dhe punëtorëve të futbollit.

Dënimi me të holla për futbollistë, sipas rangut të garave mund të jetë:

- a) Për Super-Ligë, jo më pak se; 100 €, e as më shumë se; 5000 €,
- b) Për Superligën U 21, jo më pak se; 100, e as më shumë se 3000 €,
- c) Për Ligën e Parë, jo më pak se; 100 €, e as më shumë se; 4000 €,
- d) Për Ligën e Dytë, jo me pak se; 100 €, e as më shumë se; 3000 €,
- e) Për rangjet më të ulëta se Liga e Dytë, jo më pak se; 100 €, e as më shumë se; 1000 €.

Dënimet më të holla për klubet e futbollit sipas rangjeve garuese mund të jenë:

- a) Pë klubet e Superligës jo më pak se; 1000 €, e as më shumë se; 10000 €,
- b) Për klubet e Superligës U 21 jo më pak se 500 €, e as më shumë se; 3000 €,
- c) Për klubet e Ligës së parë jo më pak se; 800 €, e as më shumë se; 5000 €,
- d) Për klubet e ligës së dytë jo më pak se; 500 €, e as më shumë se; 3000 €,
- e) Për klubet e ligës së tretë jo më pak se 200 euro, e as më shumë se 800 euro,
- f) Për klubet e futbollit të femrave jo më pak se; 200 €, e as më shumë se; 700 €,
- g) Për klubet e kategorive të juniorëve jo më pak se; 200 €, e as më shumë se; 700 €,
- h) Për klubet e kategorive të reja jo më pak se; 200 €, e as më shumë se; 500 €.

Dënimet në të holla për funksionarë, udhëheqës profesional dhe teknik, trajnerë, drejtorë, persona të cilët kryejnë funksione me kompensim material, jo me pak se; 200 €, e as më shumë se; 5000 €.

Për persona të klubeve të ligave të dyta dhe rangjeve më të ulëta jo më pak së 100 €, e as me shumë së 2000 €.

Ndëshkimet financiare paguhen në llogarinë rrjedhëse të FFK-së.

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, para fillimit të çdo edicioni të garave, me Vendim të posaqëm mundet ti ndryshoj këto dënime.

Neni 11

Afati i pagimit të dënimit të shqiptuar në të holla është **8 ditë**, nga dita kur vendimi bëhet i plotëfuqishëm.

Për rastet e jashtëzakonshme parashihet mundësia e pagimit të dënimit me të holla në këste dhe atë për lojtarë e funksionarë në afat prej 3 muajve, ndërsa për klube në afat prej 6 muajve, por kjo duhet të aprovohet nga Komisioni Organizativ i Garave, i cili duhet të përcjellë ekzekutimin e dënimit së bashku me shërbimin administrative.

Dënimet në të holla, shfrytëzohen për përmbushjen e kushteve të punës dhe të avansimit të futbollistëve të rinj.

Mospërmbushja e detyrimit nga dënimi i shqiptuar me të në të holla në afatin e përcaktuar kohor, klubin e sanksionon me mosdelegimin e zyrtarëve për ndeshjen vijuese.

I/10 Ndalesa për lojë

Neni 12

Dënimi me ndalesë për lojë mund të jetë kohor ose për numër të caktuar të ndeshjeve. Dënimi kohor me ndalesë loje nuk mund të jetë më pak se 3 muaj, e as më shumë se 4 vite, (pos në raste të përjashtimit nga organizata e futbollit), ndërsa dënimi me ndalesë loje për numër të caktuar të ndeshjeve, nuk mund të jetë më shumë se 12 ndeshje kampionale dhe për Kupë.

Lojtari i dënuar me ndalesë lojë në kohëzgjatje të caktuar, nuk mund të paraqitet në ndeshjet futbollistike publike gjatë tërë kohës sa i zgjatë dënimi.

Lojtari i dënuar me ndalesë për lojë në numër të caktuar të ndeshjeve kampionale dhe për Kupë, nuk mund të paraqitet vetëm në ato ndeshje të cilat i përfshinë ai denim.

Lojtari i dënuar me ndalesë për lojë nuk mund të përfshihet në përbërje të udhëheqësisë së klubit e as në pjesën rezervë të lojtarëve, në ato ndeshje për të cilat është shqiptuar dënimi.

Dënimi me ndalesë loje për numër të caktuar të ndeshjeve kampionale dhe të Kupës, mund të shqiptohet vetëm për kundërvajtje të kryera në terenin futbollistik dhe në rastet kur organi disiplinor vërteton se për kundërvajtjen e kryer mjafton dënimi me ndalesë loje deri në 6 muaj. Në atë rast dënimi me ndalesë loje me zgjatje kohore, mund të zëvendësohet me ndalesë loje deri në 12 ndeshje.

Me ndeshjet e Kupës, me kuptim të kësaj rregullore nënkuptohet të gjitha ndeshjet për Kupën futbollistike të Kosovës. Dënimi me ndalesë loje tërheqë edhe dënimin me kryerjen e funksionit dhe anasjelltas.

Neni 13

Dënimi me ndalesë loje me numër të caktuar të ndeshjeve kampionale dhe të Kupës, lojtari dhe zyrtari e vuan:

- Në të gjitha ndeshjet kampionale dhe të Kupës, me të cilat udhëheqë FFK-ja, respektivisht organet që i autorizon FFK-ja, kur dënimin e ka shqiptuar organi kompetent i FFK-së, respektivisht organi i subjekteve që udhëheqin me gara në rangjet më të ulëta.

I/11 Dënimi me moslojë

Neni 14

Dënimi pushon automatikisht pas ndeshjes kampionale apo të kupës, në të cilën lojtari ka pauzuar, por edhe në rastet kur lojtari i cili gjendet nën masën e dënimit është paraqitur në ndeshje (pa të drejtë loje), mirëpo, hapet procedura ndaj tij dhe Klubit.

Lojtari më dënim automatik (2 kartona të verdhë në një ndeshje), të drejten e lojës e fiton pas pauzës në një ndeshje dhe pagesës së dënimit me të holla (tërheqjen e ID së lojtarit- regjistruar në FFK).

Dënimi i menjëhershëm me moslojë në një ndeshje për KUPË, pason pas vërejtjes së dytë publike (kartona të verdhë).

Dënimi i menjëhershëm ekzekutohet në ndeshjen e ardhshme të KUPËS, çka nënkupton se kartonat e KUPËS evidencohen ndaras nga ato Kampionale (kartonat nga ndeshjet Kampionale vlejné vetëm në ndeshje kampionale, ndërsa ato të KUPËS vetëm në ndeshjet e KUPËS).

Nëse lojtari dhe zyrtari i cili është nën dënimin e menjëhershëm paraqitet në ndeshje publike, veprimi i tillë paraqet kundërvajtje disiplinore për të cilën përgjigjen: lojtari, funksionari përgjegjës i klubit dhe klubi.

Nëse lojtari i cili është nën dënimin e menjëhershëm të moslojës në një ndeshje, kalon në klub tjetër, këtë dënim do ta vuan në klubin në të cilin ka kaluar (klubin e ri).

Klubet janë të obliguara ta mbajnë evidencën për lojtarët me vërejtje publike.

Organet disiplinore gjithashtu mbajnë evidencë për lojtarët dhe zyrtarët me vërejtje publike, regjistrojnë vërejtjet në protokolet e tyre, i shpallin përmes buletineve zyrtare dhe kontrollojnë ekzekutimin e dënimeve të menjëhershme.

Neni 15

Lojtari nuk e vuan dënimin me moslojë, nëse nuk është paraqitur në ndeshje të cilën ekipi i tij e ka dorëzuar pa luftë (par-forfe).

Lojtari e vuan dënimin nëse nuk është paraqitur në ndeshjen e cila është ndërprerë.

Lojtari nuk e vuan dënimin në rastin kur ndeshja është anuluar dhe është caktuar termin i ri për zhvillimin e saj.

Lojtari i ekipit i cili e ka fituar ndeshjen pa luftë (parforfe), e ka vuajtur dënimin e menjëhershëm të moslojës në një ndeshje të tillë kampionale apo të Kupës.

Lojtari i dënuar me dënim kohorë, gjat kohës së vuajtjes së dënimit kohorë, nuk mund të paraqitet as në garat e futbollit të vogël në pajtim me dispozitat e FIFA-së.

Lojtari i përjashtuar, automatikisht suspendohet dhe nuk mund të paraqitet as për klubin e futbollit të madh e as futbollit të vogël, deri sa mos t'i shqiptohet nga ana e organit kompetent dënimi i paraparë për përjashtim nga loja.

Nëse lojtari ndëshkohet me karton të verdhë apo të kuq, kurse ndeshja ndërprehet apo anulohet, përgjegjësia për përjashtim mbetet në fuqi. Nëse ndeshja përsëritet kartonat e kuq dhe kartonat e verdhë mbeten në fuqi.

Neni 16

Lojtari zyrtari që ndëshkohet me vërejtjen e **katërt publike**, në ndeshjen e fundit kampionale në një vit garues, dënimin e moslojës në një ndeshje, e vuan në xhiron e parë kampionale të vitit të ardhshëm garues.

Lojtari që ndëshkohet me vërejtjen e dytë publike në ndeshjen e fundit (që ekipi i tij e zhvillon për KUPË, e vuan në ndeshjen e ardhshme të garave të KUPËS së Kosovës në futboll – në kampionatin e ardhshëm të KUPËS).

I/12 Ndalesa në moskryerjen e funksionit

Neni 17

Dënimi me ndalesë të kryerjes së funksionit, nuk mund të jetë më i vogël se dy muaj, e as më i lartë se dy vitë. Ky dënim shqiptohet në ndeshje muaj dhe vite të plota dhe mund të kombinohet edhe me dënim në të holla.

Personi i dënuar me këtë lloj të dënimit nuk mund të kryejë kurfarë funksioni në cilin do organ të klubit, shoqatës, lidhjes, federates, në ndeshje etj., e as ta përfaqësojë klubin apo organizatën në çfarëdo funksioni gjatë kohëzgjatjes së dënimit.

Dënimi me ndalesë të kryerjes së funksionit përfshinë edhe ndalesën e lojës.

I/13 Ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve në terrenet të caktuara

Neni 18

Organi kompetent disiplinor e cakton regjionin në të cilin zbatohet ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve, qytetin, fushën si dhe largësinë e vendit (nga vëndi fusha e të cilit është e dënuar) në të cilin lejohet që të zhvillohet ndeshja-et.

Ndalesa e zhvillimit të ndeshjeve në terrenin e caktuar ose terrenet e regjionit të caktuar, nuk mund të jenë më të larta se një vitë.

Në vend të ndalesës për zhvillimin e ndeshjeve në terrenin e caktuar apo terrenet e regjionit të caktuar në kohëzgjatje prej tre muajve, mund të shqiptohet ndalesa e zhvillimit të numrit të caktuar të ndeshjeve, me ç'rast ndalesa e zhvillimit në kohëzgjatje prej një muaji, tërheq ndalesën e zhvillimit të dy ndeshjeve.

Dënimi sipas këtij neni ka të bëjë me ndeshjet kampionale dhe të Kupës së atij klubi të cilit i është shqiptuar dënimi.

I/14 Marrja e pikëve dhe pikët negative

Neni 19

Dënimi me marrje të pikëve, mund të shqiptohet nga 3 deri në 9 (nëntë) pikë.

Klubi i dënuar me këtë dënim humb numër të caktuar të pikëve nga ato të fituara deri në kohën e shqiptimit të dënimit.

Nëse klubi nuk ka fituar mjaft pike që ndaj tij zbatohet ky dënim, këto pike do ti mirren nga ato që klubi do t'i fitojë deri në fund të kampionatit vijues. Nëse as deri në fund të atij nuk fiton pikë të mjaftuara, atëherë mbetja e dënimit të pa ekzistuar, do të bartet në vitin e ardhshëm garues.

Dënimi i marrjes së pikëve, shqiptohet ndaj atij klubi i cili ka kryer kundërvajtje për të cilën parashihet shqiptimi i një dënimi të tillë.

Klubi i dënuar me këtë dënim humb numër të caktuar të pikëve që i fiton në afat prej 6 (gjashtë) muajsh nga dita e kryerjes së kundërvajtjes.

Nëse klubi i dënuar në afat prej gjashtë muajsh nuk fiton aq pikë sa është dënimi, pjesa e mbetur e dënimit i pikëve negative shqiptohet vetëm në kampionatin e rregullt i cili zhvillohet sipas sistemit të pikëve.

I/15 Dënimi i klubeve dhe ekipeve të tyre

Neni 20

Dënimi për klub mund të jetë ndaj tërë klubit që dmth. për të gjitha ekipet e atij klubi apo vetëm ndaj ekipit të caktuar (të seniorëve, ose të juniorëve, kadeteve ose të pionerëve, që ka kryer kundërvajtje e të cilit organi dicitlinor i ka shqiptuar një dënim të tillë.

Neni 21

Përpos dënimeve nga kjo Rregullore Disiplinore, të gjithë anëtarët e FFK-së, dhe personat apo organizatat e lidhura me futboll i nënshtrohen edhe dispozitave të Ligjit mbi parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në sport.

I/16 Kthimi në rang më të ulët të garave

Neni 22

Dënimi me kthim në rang më të ulët të garave, është dënimi më i rëndë disiplinorë që mund t'i shqiptohet klubit dhe nënkupton kthimin në rangun e parë të ardhshëm më të ulët të garave.

Dënimi nga alinea e parë e këtij neni, ekzekutohet posa të bëhet i plotëfuqishëm vendimi. Nëse garat janë në zhvillim e sipër, klubi-ekipi i dënuar mbetet jashtë garave deri në vitin e ardhshëm garues.

Për klubet e rangut më të ulët garues largimi i tyre bëhet me kohëzgjatje prej: 2 – 4 edicione ndalesë të kthimit në garat e rregullta (klubet e ligave të dyta, ligave të treta, kategorive të reja dhe shkollave të futbollit).

I/17 Ndërrimi i udhëheqësisë

Neni 23

Dënimi me ndërrimin e udhëheqësisë paraqet, largimin e të gjithë personave nga pozitat e udhëheqësisë në klub apo organizatë të futbollit.

Këtë dënim, pas propozimit të arsyetuar të organit disiplinor, e shqipton organi më i lartë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, kur janë në pyetje klubet respektivisht organizatat e Superligës, Ligës së Parë, Ligës së Dytë dhe të Tretë, subjektet që udhëheqin me klubet e rangut më të ulët. Organi që e ka shqiptuar këtë dënim, ndërmerr masat gjegjëse lidhur me zgjedhjen e udhëheqësisë, sipas dispozitave të Statutit të klubit apo organizatës gjegjëse.

I/18 Përjashtimi nga klubi

Neni 24

Lojtari apo funksionari i përjashtuar nga klubi, humb cilësinë e anëtarit të klubit, andaj në emër të atij klubi nuk mund të paraqitet askund dhe kurrësesi lidhur me sportin e futbollit.

Vendimin mbi përjashtimin nga klubi, e merr organi disiplinor i klubit në bazë të dispozitave të veta.

I/19 Përfshirja nga organizata e futbollit

Neni 25

Person i dënuar me këtë lloj dënimi, fshihet nga anëtarësia e organizatës së futbollit dhe nuk mund të kryej kurfarë funksioni në sportin e futbollit. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të FFK-së.

I/20 Matja e dënimit

Neni 26

Me rastin e matjes së dënimit të kryesit të kundërvajtjes disiplinore, duhet të mirren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat ekzistojnë në rastin konkret, posaçërisht pesha e kundërvajtjes disiplinore dhe pasojat e saj, shkalla e përgjegjësisë së kryesit, motivi i kryerjes, sjelljet e mëparshme, vetit morale dhe qëndrimi (sjelljet) e kryesit pas kryerjes së kundërvajtjes disiplinore.

Nëse vërtetohen rrethanat lehtësuese të jashtëzakonshme, mund të shqiptohet dënimi edhe më i butë.

Neni 27

Llojet e dënimeve të parapara me nenin 8, të kësaj rregullore, janë të përcaktuara sipas peshës nga më e lehta deri të më e rënda, përveç dënimeve nga pika 4, nën d dhe f, të cilat shqiptohen mbi baza të ndryshme, andaj janë të pa zëvendësueshme.

Me rastin e zbutjes së dënimit sipas dispozitave të nenit 26, të kësaj rregullore, që do të thotë shqiptimi i dënimit më të butë se sa ai që është i paraparë për kundërvajtjen e kryer, atëherë shqiptohet dënimi i parë me radhë më i butë.

Në rastet kur kjo rregullore parasheh mundësinë e dënimit më të butë, në vend të dënimit të paraparë për kundërvajtjen e caktuar disiplinore, mund t'i shqiptohet dënim më i vogël (ulët) i atij lloji tjetër më të butë.

Dënimi me përjashtim nga organizata e futbollit, mund të zëvendësohet me dënim ndalese për lojë, respektivisht ndalim të ushtrimit të funksionit.

Neni 28

Nëse janë kryer disa kundërvajtje, atëherë do të vërtetohet: së pari lartësia e dënimit për secilën kundërvajtje, pastaj shqiptohet dënim unik i cili nuk mund të jetë më i lartë se dyfishi i dënimit më të rëndë të vërtetuar për kundërvajtje.

I/21 Rasti i rëndë

Neni 29

Si raste të rënda të kundërvajtjeve disiplinore, për të cilat organet disiplinore mund t'i shqiptojnë kryesit dënimin më të rëndë, konsiderohen ato kundërvajtje, gjatë kryerjes së të cilave, kryesi ka vepruar me vendosmëri, këmbëngulësi dhe paarësyeshmëri të posaqme ose kur kundërvajtja ka shkaktuar pasojë posaçërisht të rënda ose është kryer nën rrethanat posaçërisht të rënda.

Neni 30

Organi disiplinor mund t'i shqiptojë dënim më të rendë se sa dënimi i paraparë për kundërvajtje, nëse kryesi ka qenë edhe më parë i ndëshkuar për kundërvajtje.

Kur kemi të bëjmë me kryesin i cili më parë ka qenë i dënuar dy e më shumë here për kundërvajtje të kryera me dashje, kur ndërmjet vendimit të mëparshëm dhe vendimit të ri, nuk ka kaluar kohë më e gjatë se një vitë dhe kur të kryesi i kundërvajtjes ekziston prirja e posaqme për kundërvajtje, atëherë organi disiplinorë mund të ashpërsojë dënimin ndaj kryesit deri në dyfishin e dënimit të paraparë me rregullore.

I22 Parashkrimi

Neni 31

Procedura disiplinore nuk mund të hapet ndaj kryesit, e as nuk mund të dënohet kryesi i kundërvajtjes, nëse paraqitja ushtrohet: dy muaj pas kryerjes së kundërvajtjes. Parashkrimi absolut paraqitet (shfaqet) 1(një) vit, pas kryerjes së kundërvajtjes.

I23 Marrja e deklaratës me shkrim

Neni 32

Askush nuk mund të dënohet pa u marrë deklarata (dhënia e deklaratës me shkrim). Konsiderohet se kryesi është trajtuar, nëse delegati i ndeshjes e ka sjellë deklaratën me shkrim të kryesit ose nëse pas ftesës së delegatit të ndeshjes ose organit kompetent kryesi i vepres nuk ka dërguar deklaratën e vetë me shkrim (më së largu 48 orë pas përfundimit të ndeshjes).

I24 Fshirja e dënimit

Neni 33

Kryesi i kundërvajtjes disiplinore i cili është dënuar me vërejtje apo qortim, i cili në afat prej 6 muajsh nuk kryen kundërvajtje tjetër disiplinore, konsiderohet se nuk ka qenë i dënuar.

Kryesi i kundërvajtjes disiplinore i cili është dënuar me të holla apo dënim kohor deri në 6 muaj, apo ndalesë loje në numër të caktuar të ndeshjeve, po qe se gjatë një viti pas vuajtjes së dënimit nuk kryen kundërvajtje tjetër disiplinore, konsiderohet se nuk është i dënuar.

Kryesi i kundërvajtjes disiplinore i cili është i dënuar me dënim kohor mbi 6 muaj ose marrjen e pikëve, po qe se në afat prej tri viteve nga vuajtja e dënimit nuk kryen kundërvajtje tjetër disiplinore, konsiderohet se nuk është dënuar.

Ndërsa dënimi me përjashtim nga organizata e futbollit dhe dënim me kthim në rang më të ultë të garave nuk fshihet nga evidence ndëshkimore.

Neni 34

Regjistrin e dënimeve e udhëheq organi disiplinor. Vendimet e plotëfuqishme mbi dënimin për përjashtim nga organizata e futbollit, vendimet mbi dënimin e funksionarëve dhe vendimet mbi dënimet kohore mbi 6 muaj, mund t'i dërgohen edhe Departamentit për sport dhe Komitetit Olimpik të Kosovës.

I/25 Veprimi i vendimeve disiplinore

Neni 35

Vendimet e organeve kompetente disiplinore të organizatës së futbollit, veprojnë në suaza të tërë organizatës së futbollit, ndërsa vendimet e organeve disiplinore të klubeve nëse nuk jënë të vërtetuara nga ana e organit disiplinor të organizatës së futbollit, veprojnë vetëm në suaza të klubit të caktuar.

126 Vërtetimi i dënimit të shqiptuar nga ana e klubit

Neni 36

Vendimin mbi dënim të cilin e shqipton klubi, vepron vetëm në suaza të klubit. Mirëpo, nëse organi disiplinor kompetent, i udhëheqësisë së futbollit e vërteton këtë dënim të shqiptuar, atëherë ai vepron si ç'do dënim tjetër disiplinor, i shqiptuar nga organi kompetent i FFK-së.

Organi kompetent disiplinor nuk mund të vërtetojë dënimin që e ka shqiptuar klubi pas përfundimit të ndeshjes së fundit të vitit garues gjegjës. Klubi mund t'ia dorëzojë FFK-së, vendimin mbi dënim, në afat prej 8 ditëve. Nëse FFK-ja, e vërteton dënimin, ai vepron si ç'do vendim tjetër i organit kompetent disiplinor të FFK-së.

127 Përgjegjësia e klubeve për punën e zyrtarëve të tyre

Neni 37

Për të gjitha kundërvajtjet që i kryejnë anëtarët e organeve të klubeve dhe zyrtarët e klubeve, si dhe përfaqësuesit e klubeve, përgjegjësi mund të bartin edhe vetë klubet e tyre.

128 Cenimi i dispozitave dhe sjelljes shoqërore sportive

Neni 38

Për çdo kundërvajtje e cila shprehimisht nuk është paraparë me këtë rregullore, dhe e cila paraqet cenimin e statutit dhe rregulloreve të Federatës së Futbollit të Kosovës, ose tejkalon suazat e zakonshme të veprimtarisë së lejuar sportive dhe shoqërore dhe e cila me karakteristikat e veta i ngjanë njëres prej kundërvajtjes së paraparë në këtë rregullore, kryesi i saj do të ndëshkohet me llojin e dënimit gjegjës, të paraparë për rast të ngjajshëm.

II. PJESA E POSAÇME / Shkelejet e Dispozitave të Përgjithshme

II/1 Vërejtja publike

Neni 39

Lojtari i cili në ndeshjet kampionale ndëshkohet më 4 kartona të verdhë, dënimin e kryen në ndeshjen e radhës obligativisht.

Lojtari i ndëshkuar më 2 (dy) kartona të verdhë në ndeshjet e KUPËS, automatikisht duhet të pauzoj në ndeshjën e radhës.

Lojtari i cili në ndeshjet kampionale dhe të Kupës ndëshkohet me karton të kuq, dënohet me ndalesë loje prej dy deri në gjashtë ndeshje dhe dënimi ekzekutohet në ndeshjen e radhës kampionale apo për Kupës.

Lojtari i cili ndëshkohet me dy kartona të verdhë-një të kuq në një ndeshje, ai menjëherë e humb të drejtën e lojës në ndeshjen e ardhshme të klubit të tij.

Nëse është kampionale ajo ekzekutohet në ndeshjen e radhës, nëse është për Kupë atëherë lojtari i ndëshkuar në këtë mënyrë nuk mund të paraqitet në ndeshjen e radhës për Kupë.

Lojtari përveq dënimit të menjëhershëm të moslojës nga al. 1. dhe dënimit tjetër nga al. 2. e këtij neni, për çdo vërejtje publike, do të dënohet edhe me të holla, lartësinë e të cilit e cakton Bordi i FFK-së, me vendim të posaqëm para fillimit të vitit garues.

Me vërejtje publike, në kuptim të kësaj rregullore konsiderohen të gjitha vërejtjet publike që ua shqipton gjyqtari lojtarëve para, gjatë apo pas lojës, lidhur me lojën, duke zbatuar rregullat e lojës së futbollit dhe shënuar ato në protokolin e ndeshjes, nga minuta e parë e deri në minutën e fundit të ndeshjes (duke përfshirë edhe vazhdimin dhe ekzekutimin e penalltive) ose ndeshjes së ndërprerë para kalimit të kohës së paraparë me Rregullat e lojës së futbollit.

Gjyqtari është i obliguar që delegatit të ndeshjes t'ia paraqet çdo vërejtje publike të cilën e ka shqiptuar në ndeshje, ndërsa vëzhguesi duhet t'i shënojë në protokolin e ndeshjes. Nëse këtë gjë e lëshon ta bëjë vëzhguesi pas zbatimit të procedurës së caktuar, këtë e evidenton organi kompetent i cili udhëheqë me gara.

Kur mbas procedurës së zbatuar, vërejtja publike shënohet, atëherë konsiderohet se është shënuar në momentin e përpilimit të protokolit.

Gjyqtarët dhe delegati të cilët nuk i paraqesin respektivisht nuk i shënojnë vërejtjet publike të ndeshjes në protokol, do të dënohen me ndalesë të referimit gjegjësisht vëzhgimit prej 6 muaj, e deri në 1 vit.

II/2 Sjellja josportive

Neni 40

Kush sillet në mënyrë josportive ndaj lojtarit të ekipit të vetë apo të ekipit kundërshtar, ndaj referëve, funksionarit, udhëheqësve të organizatave sportive dhe shikuesëve, gjatë zhvillimit të lojës, pas përfudimit të lojës në teren dhe jashtë tij, por në lidhje me lojën e futbollit do të dënohet:

- a) me vërejtje,
- b) qortim,
- c) dënim në të holla, nga 100 deri 5000€,
- d) ndalesë loje deri në; 2 deri 6 ndeshje (lojtarë dhe zyrtarë),
- e) ndalesë të kryerjes së funksionit prej; katër deri në dymbëdhjetë muaj.

Me sjellje josportive nënkuptohet: fyerja (ofendimi), gjestet e pahijshme, reagimet dhe shkeljet e vendimeve të gjyqtarëve dhe urdhëresave të udhëheqësisë të organizatave të futbollit dhe funksionarëve që ushtrojnë detyrë të caktuar, si dhe nxitja e lojtarëve kundërshtarë apo bashkëlojtarëve, funksionarëve dhe shikuesëve, me fjalë, lëvizje dhe gjeste, si dhe të gjitha veprimet të cilat mund të dëmtojnë autoritetin e sportit të futbollit.

Neni 41

Përrjashtimi lojtarit dhe zyrtarëve të ndeshjës nga loja Sjellja jospportive ndaj shikuesve

Kushdo që sillet në mënyrë jospportive (disproporcionale) ndaj shikuesve me fjalë, lëvizje, ose në mënyra tjera do ti shqiptohet masa disiplinore:

- a) denim me të holla,
- b) ndalesë loje deri 6 ndeshje,
- c) zyrtarët; deri në 6 ndeshje ose,
- d) ndalesë në kryerje të funksionit deri në; 6 (gjashtë) muaj.

Neni 42

Sjellje jospportive ndaj gjyqtarëve dhe asistentëve të ndeshjës:

- a) Kushdo që sillet në mënyrë jospportive joproporcionale drejtë gjyqtarëve dhe asistentëve të ndeshjës, para, gjatë dhe pas loje, në terren dhe jashtë tij do ti shqiptohet masa disiplinore.

42.1 Nëse ka të bëjë me reagim në pakënaqësi të vendimit të gjyqtarit, pa sharje ose ofendime do ti shqiptohet masa disiplinore:

- a) qortim,
- b) dënim në të holla,
- c) ndalesë loje deri në 6 ndeshje,
- d) për zyrtarët; ndalesë në kryerjen e detyrave zyrtare deri në 6 ndeshje,
- e) për zyrtarët; ndalesë në kryerjen e detyrave zyrtare në klub deri në 6 muaj.

42.2. Për shtyrje, sharje ose ofendime ndaj gjyqtarit – asistentit:

- a) ndalesë loje prej; 2 – 6 ndeshje,
- b) ndalesë loje prej; 4 – 12 ndeshje,
- c) për zyrtarët; ndalesë në kryerjen e detyrës zyrtare prej; 2 – 6 ndeshje,
- d) për zyrtarët; ndalesë në kryerje të funksionit në klub prej; 4 – 12 ndeshje.

42.3. Për pështyrje të gjyqtarit – asistentit:

- a) Ndalesë loje prej; 4 – 10 ndeshje.
- b) Ndalesë loje prej; 6 muajve deri në; 1 vitë.
- c) Ndalesë funksioni prej; 6 muajve deri në; 1 vitë (për zyrtarët).

II/3 Loja brutale

Neni 43

Lojtari i cili luan në mënyrë brutale do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej; 3 deri në 5 ndeshjesh nëse nuk ka lëndime,
- b) me ndalesë loje prej; 4 deri 10 (dhjetë) ndeshje me lëndime serioze.

Me lojë brutale nënkuptohet kontakti i drejtëpërdrejtë me lojtarin kundërshtar i cili është në kundërshtim me rregullat ekzistuese të lojës së futbollit, si dhe starti me dy këmbë, loja me xhon

(thembër) rrezimi i kundërshtarit nga prapa me qëllim të lëndimit respektivisht tejkalimi i vetëmbrojtjes etj.

Për loje brutale mund të dënohet edhe lojtari i cili nuk ka marrë vërejtje publike gjate ndeshjes (karton të verdhë apo të kuq) por pas përfundimit të ndeshjes përmes TV inqizimeve, raporteve të mjekut (ku shihet shkalla e dëmtimit të lojtarit) inicohet procedura nga ana e Komisionit përgjegjës të garave sipas detyres zyrtare.

II/4 Loja e rrezikshme

Neni 44

Kush luan në mënyrë të rrezikshme, por nuk i shkakton lëndime lojtarit kundërshtarë, do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej 3 (tri) ndeshje deri 6 (gjashtë) ndeshje.
- b) dënim me të holla nga; 100 deri 5000 €.

Kush luan në mënyrë të rrezikshme dhe e lëndon lojtarin kundërshtarë, do të dënohet:

- c) me ndalesë loje prej 6 (gjashtë) ndeshje deri në 10 (dhjete) ndeshje.
- d) denim me të holla nga; 500 deri 5000 €.

Ndërsa në raste posaqërisht të rënda dhe kur lojën e tillë e përsërit edhe pas vuajtjes së dënimit për kundërvajtje të këtillë, do të dënohet më përjashtim nga organizata e futbollit.

Me lojë të rrëzikshme nënkuptohet loja e tillë, si pasojë e të cilës paraqitet ose ka mundur të paraqitet paaftësimi i përhershëm apo për një kohë të gjatë i lojtarit kundërshtar.

Për tentim do të dënohet.

II/5 SULMI FIZIK

Neni 45

Lojtari i cili e godit bashkëlojtarin apo lojtarin kundërshtarë kur ky nuk e posedon topin, do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej; 2 – 4 ndeshje ose; 4 – 12 ndeshje (varësisht prej rasteve),
- b) ndërsa në raste më të rënda apo të përsëritura, prej 12 deri në 24 muaj,
- c) denim me të holla nga; 500 deri 5000€.

Për tentim të sulmit fizik, do të dënohet në lartësi të gjysmës së dënimit të paraparë për këtë kundërvajtje.

Neni 46

Lojtari i cili fizikisht e sulmon bashkëlojtarin apo lojtarin kundërshtar gjatë zhvillimit të lojës në terren apo jashtë terrenit, por në lidhje me sportin e futbollit do të dënohet:

- a) me ndalesë loje në kohëzgjatje prej; 2 – 6 ndeshje,
- b) apo prej; 4 – 12 ndeshje (varësisht prej rasteve).

Ndërsa në raste më të rënda kur vërtetohet se lojtari i ka shkaktuar ose ka pasur për qëllim shkaktimin e lëndimeve të rënda do të dënohet:

- a) me ndalesë loje në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, deri në 2 (dy) vite ose përjashtim nga organizata e futbollit.
- b) dënim me të holla nga; 500 deri 5000 €.

Për tentim do të dënohet me gjysmën e dënimit të paraparë në këtë nen.

Neni 47

Lojtari i cili fizikisht e sulmon gjyqtarin në terren apo jashtë tij, por në lidhje me sportin e futbollit do të dënohet:

- a) në raste të lehta, kur nuk ka lëndime trupore, me ndalesë loje prej 2 (dy), deri në 4 (katër) vite,
- b) ndërsa në raste të rënda kur i shkakton lëndime trupore të cilat i konstaton mjeku me certifikatë mjekësore, dënohet me përjashtim nga organizata e futbollit,
- c) dënim me të holla nga; 500 deri 5000 €.

Për tentim do të dënohet me gjysmën e dënimit të paraparë për sulm.

Neni 48

Lojtari me fajin e të cilit ndërpritet ndeshja e cila nuk vazhdon më, do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej; 4 – 12 ndeshje,
- b) me dënim me të holla nga; 500 deri 5000 €.

Neni 49

Lojtari i cili fizikisht e sulmon anëtarin e udhëheqësisë së organizatës së futbollit apo përfaqësuesin (vëzhguesin) e saj gjatë ushtrimit të funksionit apo detyrës së tij zyrtare, apo edhe e kundërta) do të dënohet sipas dispozitave të rregullores disiplinore:

- a) ndalesë loje prej; 4 – 12 muaj,
- b) kryerje të funksionit; 4 – 12 muaj (**zyrtarët**),
- c) për raste të rënda; ndalese loje për 1 vitë,
- d) ndalese funksioni për; 1 vitë ose përjashtim nga organizata e futbollit.

Për tentim do të dënohet me gjysmën e paraparë për këtë vepër.

Neni 50

Lojtari i cili fizikisht sulmon shikuesin gjatë zhvillimit të ndeshjes ose pas përfundimit të sajë, do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej; 6 deri në 10 ndeshje (varësisht prej rasteve),

- b) me dënim me të holla nga; 500 deri 5000 €.

Për tentim do të dënohet me gjysmën e paraparë për këtë vepër.

Neni 51

Punëtori sportiv i cili fizikisht sulmon lojtarët, funksionarët e klubit kundërshtarë apo shikuesit, do të dënohen:

- a) me ndalesë të ushtrimit të funksionit prej; 6 (gjashtë) muaj, deri 1 një vitë.

Nëse punëtori sportive fizikisht e sulmon funksionarin e udhëheqësisë së organizatës së futbollit, vëzhguesin e ndeshjes apo gjyqtarin do të dënohet:

- b) me ndalesë të kryerjes së funksionit me kohëzgjatje prej; 1 (një), deri në 2 (dy) vite.

Ndërsa në raste më të rënda:

- c) me përjashtim nga organizata e futbollit.

Për tentim do të dënohet me gjysmën e paraparë për këtë vepër.

Për pjesëmarrje në përleshje:

- d) lojtari; dënohet prej; 4 – 10 ndeshje,
- e) funksionari; dënohet prej; 4– 6 muaj ndalesë të kryerjes së funksioneve në klub lidhur me ndeshjet e organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

II/6 Organizimi i dobët dhe trazirat në teren

Neni 52

Klubi i cili nuk e organizon ndeshjen në pajtim me dispozitat e Propozicioneve dhe rregullores së garave (nuk ndërmerr masat e nevojshme organizative dhe të sigurisë), nuk cakton kujdestarë apo ata i cakton në numër jo të mjaftueshëm, nuk njofton-siguron organet e sigurimit në afatin e paraparë për sigurimin e ndeshjes, do të dënohet:

- a) me vërejtje,
- b) me qortim ose,
- c) me të holla,
- d) me regjistrimin e ndeshjes 0:3 (në të mirë të kundërshtarit për mos zhvillim të ndeshjes për shkak të mos presences të organeve të sigurimit dhe të Policisë).

Neni 53

Klubi organizator i ndeshjes në terrenin e të cilit para ndeshjes, gjatë dhe pas ndeshjes, lidhur me ndeshjen ndodhin trazira dhe nëse vërtetohet se nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme, si dhe klubi mysafir simpatizuesit e të cilit shkaktojnë apo marrin pjesë në trazira, do të dënohet në rastë më të lehtë:

- a) në rast të hedhjes së gjësendeve të forta pa pasoja, në terren-dënimi me të holla.

- b) në raste të hedhjes së mjeteve piroteknike, gjësendeve të forta përleshjes së publikut në mes vete, hyrjes në fushë, të publikut, prishjes së perimetrit të sigurisë (pa pasoja në zyrtarë dhe pjesëmarrësve në lojë), mund të shqiptohet dënim me të holla, dënim të fushës, dënim të publikës për përcjellje të ndeshjes (ndeshje pa prezencë të spektatorëve).
- c) në raste të tentimit të sulmit të publikut ndaj personave zyrtar apo futbollistëve të të dy ekipeve – mund të dënohet me moszhvillimin e; 2 (dy) deri në 4 (kater) ndeshjeve në fushën e vetë pa praninë e shiqesëve, dënim me të holla.
- d) nëse sulmohën personat zyrtarë, dhe futbollistët e të dy ekipeve nga ana e publikut vendas por me përmasa më të vogla (shtyerje, tërheqje me dorë) atëherë klubi mund të dënohet prej; (2) deri në kater (4) ndeshje jashtë fushës së vet.
- e) në raste të rënda (goditje shqelmime me duar dhe këmbë apo me gjësende të forta) dhe kur ka lëndime fizike - dënimi prej; katër (4) deri në (8) ndeshje mos zhvillimi në fushën e vet.
- f) në raste jashtëzakonisht të rënda, kur pasojat e trazirave janë posaçërisht të rënda, me largim nga rangu përkatës i garave, në rang më të ulët.

Sulmi fizik i shikuesve të të dy palëve ndaj pjesëmarrësve të lojës-lojtarëve, lojtarëve rezervë, apo personave profesional teknik dhe zyrtarë (vëzhgues e gjyqtarë), dhe trazirat e shkaktuara të shiqesëve në dhe rreth stadiumit, para, gjatë, apo pas ndeshjes, konsiderohen kundërvajtje e rëndë në pajtim me alinen 1 të këtij neni.

Nese dëmi material është shkaktuar për shkak të organizimit të dobët; klubit kundërshtar ose zyrtarëve (dëmet në pajisje, veshje, këpucë, makinave, autobusëve, klubi organizator është i detyruar të bëjë kompensimin për palën e dëmtuar. Shuma e dëmit të shkaktuar përcaktohet me vendim të organit kompetent.

II/7 Ndërprerja e lojës, lëshimi i terrenit, moszhvillimi i lojës

Neni 54

Nëse ekipi sillet në terren ashtu që shkakton trazira dhe ndeshja ndërpritet e nuk vazhdon, do të dënohet:

- a) me marrjen e 3-9 pikë ose me; 3-9 pikë negative.

Nëse ndërprerja e tillë është shkaktuar me fajin e një apo më shumë lojtarëve, atëherë ata lojtarë do të dënohen:

- b) prej; 4 deri në 8 ndeshje zyrtare apo
- c) me ndalesë loje në kohëzgjatje prej; 8 ndeshjeve deri në 12 muaj, mvarësisht nga pasojat.

Në raste posaçërisht të rënda:

- d) me ndalesë loje prej 1 (një) deri në 2 (dy) vite, apo
- e) me përjashtim nga organizata e futbollit.

Neni 55

Lojtari, stafi profesional apo zyrtari i klubit i cili cytë ekipin për shkaqe të ndryshme që ta lëshoj fushën, ose që mos t' a fillojë ndeshjen e caktuar dënohet:

- a) prej; 6 - 12 muaj per lojtare dhe funksionar dhe rastet me të renda,
- b) me ndalesë të ushtrimit të funksionit, në kohëzgjatje prej 1 (një), deri në 2 (dy) vite,

Ndërsa në raste më të rënda apo të përsëritura:

- a) me përjashtim nga organizata e futbollit.

Nëse pranojnë nxitjen dhe terrenin e lëshojnë katër lojtarë, e ndërsa të tjerët vazhdojnë lojën, lojtarët që e kanë lëshuar lojën do të dënohen:

- b) me ndalesë loje prej 6 (gjashtë) muaj, deri në 1 (një) vitë.

Nëse terrenin e lëshojnë së paku 5 lojtarë dhe ekipi nuk e fillon respektivisht nuk e vazhdon lojën, lojtarët dënohen:

- a) me ndalesë loje prej 6 (gjashtë) muaj, deri në 1 (një) vitë.
- b) ndërsa ekipi me marrjen prej; 3 deri në 9 (nëntë) pikë negative.

Neni 56

Ekipi i cili pa arsye nuk paraqitet në dy ndeshje të garave të përherëshme (kampionale) në vitin e njejtë garues do të dënohet:

- a) me kthim në rang më të ulët të garave dhe denim me të holla 1,000 deri 50,000 €.
- b) Për klubet e rangjeve më të ulëta dhe lidhjet rajonale dënimi të shqiptohet me ndalesë pjesëmarrje për 3 edicione.

II/8. Tërheqja nga garat

Neni 57

Ekipi i cili pa arsye tërhiqet nga garat, do të dënohet:

- a) bie në një rang më të ulët të Garave,
- b) me 9 pikë negative, ashtu që ky dënim ekzekutohet ndaj atij klubi, në garat e para të ardhshme kampionale, në rangun përkatës,

II/9. Paraqitja e parregullt e lojtarëve

Neni 58

Lojtari është paraqitur në mënyrë të parregullt nëse ka luajtur:

- a) me librezën e lojtarit tjetër,
- b) për klubin për të cilin nuk është i regjistruar,
- c) për klubin e vetë para se të fitojë të drejtën për lojë,

- d) në ekipin e klubit tjetër në ndeshje miqësore të karakterit humanitarë, pa lejen e organit kompetent,
- e) pa kontrollimin e vlefshëm mjekësor ose kur nga ana e mjekut të ndeshjes i ndalohet paraqitja në lojë,
- f) kur gjatë 48 orëve është paraqitur edhe në një ndeshje tjetër,
- g) kur me dispozitat e rregullores mbi garat nuk ka të drejtë paraqitje,
- h) kur ndodhet nën suspendim apo denim, në këto raste ekipi i tij do ta humbë ndeshjen me rezultat zyrtar 3:0 (parforfe), si dhe marrjen e deri nëndë pike negative, ndërsa lojtari i tillë do të dënohet:
 - prej; 4 deri në 12 ndeshje zyrtare,
 - ndërsa ekipi me marrjen prej; 3 deri në; 9 pikë, nëse është ndeshje e kupës ndalesë për 2 – 3 edicione në këtë garë.

Me shprehjen paraqitje në kuptim të këtij neni, nënkuptohen lojtarët rezerve të shënuar në protokol dhe të cilët nuk kanë hyrë në lojë.

II/10. Përdorimi i mjeteve stimulative të palejuara

Neni 59

Lojtari i cili përdorë mjete të palejuara stimulative për forcimin e aftësisë fizike, do të dënohet:

- a) me ndalesë loje prej 6 muaj deri në 1 vitë; në raste të rënda apo të përsëritura
- b) me ndalesë loje prej 1 deri në 2 vitë, ose
- c) me përjashtim nga organizata e futbollit.

Klubi me dijen e të cilit lojtari apo lojtarët kanë shfrytëzuar mjete të palejuara stimulative do të dënohet:

- a) me marrjen prej 6 deri në 9 pikë.

Në raste më të rënda ose të përsëritura:

- b) me kthim në rangun më të ulët të garave.

Mjeteve të palejuara stimulative, konsiderohen barnat që janë në regjistrin e mjeteve stimulative të ndaluara, të cilin regjistër e ka vërtetuar Këshilli Olimpik Ndërkombëtar.

II/11 Cytja, mitosja, marrëveshja dhe Kurdisja e rezultatit

Neni 60

Lojtari, stafi profesional apo zyrtari i klubit i cili:

- a) cytë lojtarët me kontakt të drejtëpërdrejtë ose përmes personit tjetër që mos të luajë ashtu siq dijnë më së miri dhe mos të angazhohet për ekipin e vet.

- b) premtom ose ofron dhuratë ose ndonjë të mirë tjetër materiale lojtarit me kontakt të drejtëpërdrejtë ose përmes personit tjetër që një apo më shumë lojë t'i kurdisë, luan ashtu që t'i ndihmojë ekipit tjetër.
- c) cytë, arrin marrëveshje, premtom ose ofron dhuratë, të mirë tjetër materiale lojtarit, zyrtarit të klubit, gjyqtarit.
- d) cytë anëtarë të organizatës së futbollit që të kurdisë rezultatet e ndeshjes, të bëjë atë që është kundër dispozitave ekzistuese, respektivisht të mos bëjnë atë çka janë të obliguar të bëjnë sipas dispozitave të organizatës së futbollit.
- e) mosangazhimi në lojë (lëshimi i qëllimshëm i kundërshtarit të jap gol pa angazhim, angazhim inert, mos dëshirë për lojë, dëmtim i ekipit të tij me qëllim, etj...).
- f) pranon ofertën nga ana e lojtarëve, klubit, gjyqtarit dhe zyrtarëve për të cilin do prej rasteve të sipërpërmendura, do të dënohet:
 - lojtari, me ndalesë loje në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në 1 vitë,
 - dënimi me të holla nga 500 deri 2000 €,
 - zyrtari i klubit, gjyqtari dhe anëtari i udhëheqësisë së futbollit, me ndalesë të kryerjes së funksionit, përkatësisht referimit në kohëzgjatje prej 1 deri në 2 vite,
 - klubi, marrjen e 9 pikëve ose – 9 pikëve dhe dënimi me të holla nga;1000 deri 10000 €,
 - klubi me largim nga rangu përkatës i garave dhe dënimi me të holla nga;1000 deri 10000 €.
- g) Ndërsa në raste të rënda dhe të përsëritura dënohen:
 - lojtari, me ndalesë të gjatë loje ose përjashtim nga organizata e futbollit,
 - stafi profesional (trajnerët), zyrtarët e klubit, zyrtarët e ndeshjes, gjyqtari ose pjesëmarrësi tjetër në ndeshje ose gara, me ndalesë së kryerjes së funksionit, referimit ose përjashtim nga organizata e futbollit.

Çdo tentim i zyrtarëve të klubit për të kontaktuar me zyrtarët e FFK-së të deleguar për ndeshje, me qëllime jo të lejuara do të konsiderohet tentim për mitosje.

II/12. Shpifja dhe fyerja

Neni 61

Anëtari i organeve të FFK-së, apo zyrtari i klubit i cili fyen, shpif ose përhapë të pa vërteta për klubin tjetër, për lojtarin e vet apo kundërshtarët, për punëtorin e futbollit të cilit do klub apo anëtarë të udhëheqësisë së organizatës së futbollit të të cilit do organ, për gjyqtarin ose trajnerin, do të dënohet:

- a) lojtari, me ndalesë loje prej 3 deri në 6 muaj dhe dënim me të holla 200 deri 1000 €,
- b) funksionari, me ndalesë të kryerjes së funksionit prej 6 muaj deri në 1 vitë dhe dënim me të holla 200 deri 2000 €,

Ndërsa në raste të rënda apo të përsëritura, do të dënohet:

- c) lojtari, me ndalesë loje së paku 6 muaj dhe dënim me të holla 500 deri 2000 €,
- d) punëtori sportiv, me ndalesë të kryerjes së funksionit më së paku 1 vitë dhe dënim me të holla 500 deri 3000 €,

- e) ndërsa klubi, me marrjen deri në 9 pikë, ose dënimi me 9 pikë negative dhe denim me të holla 1,000 deri 5,000 €.

Racizmi dhe format tjera të diskriminimit

Neni 62

Çdo kush që publikisht ofendon ose diskrimonon një tjetër mbi çështjet racore; ngjyrë lëkure kombetare, rajonale, fetare ose etnike, mosdurimi jotolerant, propoaganda ideologjike, ekstremizmi i shprehur etj., denohen:

- a) Lojtari me 4 ndeshje dhe denim me të holla.
- b) Punëtori futbollit me të holla dhe me ndalese funksioni prej 3 – 6 muaj.
- c) Klubi; tifozerit e të cilit me gjeste ose bandorola me shkrim bejne ofendime dënohet.
- d) Me të holla, ndalese loje ne fushen e vetë, 1 ndeshje ose pa pranin e shikuesve deri ne 3 ndeshje dhe ne raste të renda.
- e) Klubi me pike negative deri 9 pike dhe rasti edhe me rëndë.
- f) Kthimi klubit ne rang me të ulet të garave ose diskualifikim nga garat e kupes (nese ndeshja eshte per kup).

Mosrespektimi i kodit te sjelljes per anetaret e organizates se futbollit

Neni 63

Te gjithë personat të cilet nuk e aplikojne kodin e sjelljes (të cilet shkelin dispozitat e Kodit do të dënohen:

- a) Lojtari me ndalese loje deri ne 6 muaj,
- b) Punetori futbollit dhe zyrtarët tjerë denimi me të holla dhe ndalese e funksionit deri ne 6 muaj,
- c) Lojtari ne rastet me të rënda; ndalese loje prej 3 muajve deri në 1 vitë,
- d) Punetori futbollit prej 3 muajve deri në 1 vitë por në raste edhe më të rënda përjashtim nga organizata e futbollit.

II/13. Kundërvajtjet lidhur me regjistrimin e lojtarëve

Neni 64

Lojtari, punëtori i futbollit apo klubi i cili lidhur me regjistrim:

- a) jep të dhëna të rrejshme, jo të sakta, jo të plota, e që kanë rëndësi për regjistrimin e rregullt.
- b) përmirëson apo inkorporon të dhëna të caktuara në dokumentacionin për regjistrim në librezën e futbollit, fletëçregjistrimin, vërtetimin mbi fshirjen, kontratë, etj...
- c) i cili njëkohësisht regjistrohët për dy ose më shumë klube të futbollit.
- d) të cilët në ç'farëdo mënyre tjetër sjellin në lajthim klubin e vetë apo klubin tjetër dhe udhëheqsinë e organizatës së futbollit lidhur me regjistrim, e që është i rëndësisë së posaçme për regjistrim të rregullt, do të dënohen:

- lojtari, me ndalesë loje në kohëzgjatje prej tre **muajve deri në 1 vitë** dhe dënim me të holla nga; 500 deri 2000 €.
- funksionari, me ndalesë të kryerjes së funksionit në kohëzgjatje prej 1 deri në 2 vite dhe dënim me të holla nga; 500 deri 2000 €.
- anëtari i komisionit për regjistrim me dijen e të cilit është kryer regjistrimi jo i rregullt, me ndalesë së kryerjes së funksionit prej 1 deri në 2 vite, dhe denim me të holla 500 deri 2000 €.
- ndërsa klubi, me dijen e të cilit është bërë regjistrimi jo i rregullt, me marrjen deri në 9 pikë negative dhe denim me të holla 1000 deri 5000 €.

Neni 65

Klubit, anëtarit-ve të kryesisë së klubit ose lojtarit të cilët i shfrytëzojnë shërbimet e ndërmjetësuesve të palicencuar për lojtarë, me qëllimin e lidhjes së kontratës mbi transferin në mes të dy klubeve, ose kontratën në mes lojtarit dhe klubit, të cilit ndërmjetësues të palicencuar i ipet shpërblimi për transferrin, do të shqiptohet masa disiplinore:

Klubet:

- a) Dënimi në të holla,
- b) Marrja e 3 pikëve ose 3 pikë negative dhe dënim me të holla 1000 deri 10000 €, dhe
- c) Ndalimi i regjistrimit (transferit) të lojtarëve të rinjë në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Anëtarit-ve të kryesisë ose udhëheqësve të klubit:

- a) denimi në të holla, 100 deri 5000 €, dhe
- b) ndalimi i ushtrimit të funksionit nga 6 e deri 12 muaj,
- c) përjashtimi nga Federata e Futbollit të Kosovës.

Lojtarit:

- a) denimi në të holla, 100 deri 2000 €, dhe
- b) ndalesa për lojë nga 3 muaj e deri 1 vitë.

II/14 Kundërvajtjet lidhur me licencimin e klubeve

Neni 66

Personave juridik apo fizik që janë përgjegjës ose klubeve të cilët gjatë procesit të marrjës së licencës për lejimin në garat e UEFA të klubeve dhe garave nacionale, trupave të cilët merren me këtë process të licencimit, dorëzojnë dokumentacionin e falsifikuar prezantojnë fakte të paqena, e vene në lajthitje komisionin e shkallës së parë ose të shkallës së dytë për licencim, do ju shqiptohet masa disiplinore:

Personave fizik:

- a) Dënimi në të holla.
- b) Ndalimi i zhvillimit të funksionit në klube të futbollit ose organizatën e futbollit nga minimum 1 vitë.
- c) Përjashtimi nga organizata futbollistike.

Klubeve:

- a) Vërejtje.
- b) Dënimi në të holla.
- c) Marrja e licencës së dhënë.
- d) Ndalimi në pjesënarrjen e procesit të licencimit të klubeve, në periudhën nga 1 deri 3 vite.
- e) Dënimi në të holla.

Përveq dënimeve në të holla nga paragrafi i fundit e këtij neni, klubi detyrohet që ti kthej mjetet të cilat i ka marr dhe që kanë qenë të dedikuara për të, në afatin të cilin e cakton organi përgjegjës.

II/15. Mashtrimi dhe sjellja në lajthim

Neni 67

Lojtari, punëtori i futbollit apo klubi i cili:

- a) jep të dhëna jo të sakta në protokolin e ndeshjes, librezën e futbollit, fletëçregjistrimin, vërtetimin mbi fshirje dhe dokumentacionet tjera për regjistrimin e lojtarëve,
- b) jep të dhëna të rreme dhe jo të sakta, në protokolin e ndeshjes dhe raportin e tij si vëzhgues i udhëheqësisë së garave, dhe ashtu sjellë në lajthim organin e futbollit, lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ndërmarjen e masave gjegjëse,
- c) jep të dhëna të rrejshme, jo të sakta dhe jo të plota për dispozitat mbi punën profesionale-pedagogjike, të rendësishme për garimin e klubit në rangun gjegjës,
- d) bënë keqpërdorimin e fletëhyrjes zyrtare apo billetës për hyrje gratis në stadium,
- e) bënë prezentimin e rrejshëm se kinse është punëtor sportive i klubit, shoqatës apo organizatës në ndeshjen e caktuar,
- f) mashtron dhe sjellë në lajthim udhëheqësitë e organizatës së futbollit apo klubin në ç'farëdo mënyre, do të dënohet:

- **lojtari**, me ndalesë loje prej; 6 muaj deri 1 vitë, dhe denim me të holla nga; 100 deri 2000 €.
- **funksionari**, me ndalesë së kryerjes së detyrës në kohëzgjatje prej; 1 deri në 2 vite, dhe denim me të holla nga; 100 deri 2000 €.
- **ndërsa klubi** me marrjen prej 3 deri në 9 pikë negative, dhe denim me të holla 1000 deri 10000 €.
- edhe për tentim do të dënohen me gjysmën e paraparë për veprën.

II/16 Mospërmbushja e obligimeve

Neni 68

Kush ndaj udhëheqësive të futbollit respektivisht ndaj organeve të FFK-së, nuk i përmbushë obligimet e veta:

- a) me mosdërgimin e fletëçregjistrimeve dhe librezave të futbollit, kur kjo me dispozita të futbollit parashihet si obligim,

- b) me mosëpagimin apo vonesën në pagimin e shpenzimeve për delegat, gjyqtarë dhe mosëpagimin e obligimeve tjera që rrjedhin nga marrëveshja sportive,
- c) me mospagimin e anëtarësisë për klub dhe lojtarë,
- d) me mosëparaqitjen e librezave të futbollit, protokollit dhe dokumentacioneve tjera të parapara me Propozicionet e garave, në shiqim vëzhguesit të ndeshjes,
- e) me mosëparalajmërimin apo paralajmërimin me vonesë të ndeshjeve publike,
- f) mosëparaqitjen – moslajmërimin e ndeshjeve dhe turneve,
- g) vështërsimin e punës së organeve të FFK-së,
- h) mosdorëzimin e dokumentacionit për verifikim, në afatin e paraparë,
- i) mospërbushjen e obligimeve dhe detyrave të tjera të cilat rrjedhin nga rregulloret, dispozitat tjera të FFK-së, dhe organizatave të futbollit, do të dënohen:
 - lojtari, me ndalesë loje deri në 2 muaj,
 - punëtori i futbollit, me ndalesë të kryerjes së funksionit deri në 6 muaj,

Ndërsa klubi:

- a) me vërejtje.
- b) denim me të holla nga; 1000 deri 10000€.
- c) suspendim (mosdelegim i zyrtarëve në ndeshjen e radhës).
- d) marrja e pikeve nga 3 deri 9 pikëve.
- e) Nëse klubi edhe përkundër shqiptimit të denimit, marrës së 3 pikëve, nuk përmbush detyrimet e tij të mëhershme, atëherë do të shqiptohet masa disiplinore - kthimi në një rang më të ulët të garave.

Neni 69

Klubi i cili nuk përmbush detyrimet ndaj organeve zyrtare, detyrimeve ndaj klubeve, lojtarëve, trenjerëve dhe personave zyrtar, do të shqiptohet masa disiplinore:

- a) denimi në të holla nga; 1000 deri 10000 € ose marrja deri në 9 pikë.
- b) personit zyrtar ose personave të organeve udhëheqëse të klubeve - shqiptimi i denimit në të holla nga; 1000 deri 5000 € ose ndalimi i kryerjes së funksionit deri në 6 muaj.

Klubi i cili vonohet në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale më shumë se 60 ditë, klubi apo lojtari ose i punësuar i klubi, mundën të fillojnë procedurën kundër klubit i cili ju detyrohet, (me shkrim të KRSL) për përmbushje të detyrimeve, do të mirren masa disiplinore ndaj klubit:

- a) prishjen e njëanshme të kontratës nga KRSL dhe dënim me të holla nga; 1000 deri 10000 €.
- b) ndalimi i transferimit të lojtarëve të rinjë për një ose dy afatet kalimtare të rregullta.
- c) marrja e 9 pikëve dhe dënim me të holla 1000 deri 10000 €.
- d) kthimi në rang më të ulët të garave.

II/17 Vështirësimi i hetimeve

Neni 70

Kushdo që udhëheqësive të futbollit dhe organeve të tyre ua vështirëson hetimet me mos ofrimin e të dhënave, ofrimin e të dhënave jo të sakta, do të dënohet:

- a) me qortim.

Ndërsa kur e përsërisin një veprim të tillë apo në raste të rënda:

- a) lojtari, me ndalesë loje deri në 1 vitë.
- b) punëtori i futbollit, me ndalesë të kryerjes së funksionit deri në 2 vite.
- c) ndërsa klubi, me marrjen deri në 9 pikë negative.

Për shkak të mospërgjegjjes në ftesë të parë, nëse marrja në pyetje është e domosdoshme për vërtetimin e gjendjes faktike, organi disiplinor mund të shqiptojë suspendimin e caktuar sipas dispozitave të kësaj rregullore.

Mospërbushja e vendimeve dhe urdhëresave

Neni 71

Klubi i cili nuk i përmbush vendimet dhe urdhëresat e udhëheqsisë së organizatës së futbollit si dhe nuk i përfillë obligimet që dalin nga marrëveshja me sponzorin e ligës përkatëse, do të dënohet:

- a) me denim në të holla.
- b) punëtori gjegjës i futbollit, me ndalesë të kryerjes së detyrës deri në 1 vitë.
- c) klubi, me marrjen deri 9 pikë negative.
- d) ndërsa funksionarët, me ndalesë të kryerjes së funksionit prej; 6 muaj deri në 1 vitë.

Neni 72

Nëse organi i organizatës së futbollit, bashkësisë, shoqatës së klubeve dhe organizatave profesionale, dhe pas vërejtjes së bërë nga organi më i lartë kompetent (psh. Komiteti Ekzekutiv):

- a) nuk i përfillë vendimet dhe konkluzat e Kuvendit të organizatës së futbollit,
- b) nuk i zbaton dispozitat e organizatës së futbollit të cilat është i obliguar që t'i respektojë, do të dënohet:
 - me vërejtje.
 - me qortim.
 - ose organi disiplinor, mund ta suspendoj tërë organin dhe propozoj Kuvendit ose Komitetit Ekzekutiv që të zgjedhë – caktojë anëtarët tjerë organit të suspenduar.

Punëtorët e futbollit të organeve nga al. 1 e këtij neni, do të dënohen:

- a) me vërejtje apo,
- b) me qortim.

Ndërsa në raste të rënda apo të përsëritura, do të dënohen:

- a) me ndalesë të kryerjes së funksionit prej 6 muaj deri në 1 vitë.
- b) përfaqësuesi i klubit i cili nuk nënshkruan protokolin zyrtar mund të dënohet: prej 2 deri 4 muaj.

Neni 73

Klubi i cili në afatin e caktuar nuk paguan kontributet gjegjëse, në emër të kootizimit për pjesëmarrje në gara, regjistrimit të lojtarëve, dënimeve të shqiptuara nga Komisioni Disiplinor dhe i Etikës dhe i Etikës, shpenzimeve të gjyqtarëve si dhe personave të tjerë zyrtarë, do të dënohet me të holla.

Komisioni Organizativ i Garave inicon procedurën disiplinore ndërsa Komisioni Disiplinor dhe i Etikës dhe i Etikës suspendon klubin i cili nuk përmbushë këto obligime, dhe nuk i delegohen zyrtarët e ndeshjeve të cilën ndeshje pastaj e humb “parforfe”.

II/18. Kundërvajtjet lidhur me ndeshjet ndërkombëtare

Neni 74

Klubi i cili dëshiron të luaj jashtë Kosovës, në ndonjë ndeshje ndërkombëtare, duhet të ketë lejen e organit kompetent, poqëse atë e zhvillon pa leje, do të dënohet:

- a) Punëtori sportive përgjegjës, me ndalesë të paraqitjes jashtë Kosovës në kohëzgjatje deri në 1 vitë.
- b) Me marrjen deri në 9 pikë negative.
- c) Me ndalimin e ushtrimit të profesionit deri në 1 vitë.

Ndërsa në raste të rënda apo të përsëritura:

- a) Përrjashtim nga organizata e futbollit.

Neni 75

Klubi, lojtarët apo funksionarët, të cilët me sjelljen e tyre në ndeshje të futbollit apo jashtë tyre që kryhen jashtë Kosovës, e që i shkaktojnë dëm autoritetit të vendit tone, dënohen:

- b) me ndalesë të paraqitjes jashtë vendit në kohëzgjatje deri në 1 vitë.
- c) ndërsa lojtarët apo funksionari me ndalesë loje rrespektivisht ndalesë të kryerjes së funksionit në kohëzgjatje deri në 1 vitë.

Neni 76

Klubi i cili në përbërje të ekipit të vetë e merr lojtarin i cili gjendet nën dënim apo suspendim, rrespektivisht lojtarin i cili nuk ka fituar të drejtën për lojë, do të dënohet:

- a) me marrjen deri 9 pikë negative.
- b) ndërsa lojtari, me ndalesë loje deri në 1 vitë.

Neni 77

Klubi i cili shkon jashtë vendit dhe pa leje paraqitet si reprezentacion i Kosovës, do të dënohet në kuptim të dispozitave të kësaj rregullore.

III. KUNDËRVAJTJET E GJYQTARËVE, VËZHGUESËVE TË REFERIMIT DHE DELEGATËVE

Neni 78

Gjyqtari, delegati apo vëzhguesi i referimit i cili në kohën e caktuar pa arësye nuk vjen që ta zhvillojë, kontrollojë, vëzhgojë ndeshjen, ose vjen në stadium dhe ndeshjen pa arësye nuk e udhëheq, delegon, vëzhgon, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi, delegimi, vëzhgimi, në kohëzgjatje prej 3 muaj deri në 6 muaj,
- b) në raste të rënda deri në 1 vitë,
- c) në raste të përsëritura apo posaçërisht të rënda, përjashtim nga organizata e futbollit.

Neni 79

Nëse gjyqtari e referon ndeshjen e ndaluar ose ndeshjen të cilën kolegu i tij e ka shtyrë ose ndërprerë, do të dënohet:

- a) Me ndalesë referimi në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 1 vitë.

Neni 80

Gjyqtari i cili pa arësye ndërpreu ndeshjen, ndikon në ndërprerje apo nuk e ndërpreu ndeshjen të cilën është dashur ta ndërprejë, do të dënohet:

- a) ndalesë referimi deri në 1 vitë.

Neni 81

Gjyqtarit të cilit i anulohet ndeshja për shkak të cenimit esencial të dispozitave të Rregullave të lojës së futbollit, do të dënohet:

- b) me ndalesë referimi me kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 1 vitë,

Gjyqtari i cili vlerësohet nga zyrtarët kompetentë, me notë negative (dmth. me notë 1 apo 2), do të dënohet:

- a) në raste të rënda apo të përsëritura, mund të dënohet edhe me ndalesë në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 2 vite,
- b) në raste të jashtëzakonisht të rënda, me përjashtim nga organizata e futbollit.

Gjyqtarët do të dënohen nga Këshilli profesional i Komisionit për gjyqtarë nëse vlerësohen me nota të dobëta 1 apo 2.

Neni 82

Gjyqtari, delegati dhe vëzhguesi i referimit, i cili në mënyrë jo profesionale kryen detyrën, gjatë referimit, delegimit dhe vëzhgimit, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi respektivisht kryerjes së detyrës deri në 3 muaj.

Neni 83

Gjyqtari, delegati apo vëzhguesi i referimit i cili paraqet raport jo të saktë mbi ndeshjen në të cilën ka kryer detyrën e gjyqtarit ose të gjyqtarit ndihmës, do të dënohet:

- b) me ndalesë referimi prej 6 muaj deri në 1 vitë,
- c) në raste të rënda deri në 2 vite.

Neni 84

Gjyqtari i cili merr pagesë më të lartë në emër të shpenzimeve që parashihet me aktet normative të FFK-së, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi në kohëzgjatje prej 2 deri në 6 muaj,
- b) në raste të rënda në kohëzgjatje deri në 1 vitë.

Neni 85

Gjyqtari, delegati, vëzhguesi i referimit i cili jepë deklaratë jo të saktë në mjetet publike të informimit, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi, delegimi dhe vëzhgimi deri në 6 muaj,
- b) në raste të rënda dhe të përsëritura, deri në 1 vitë.

Neni 86

Gjyqtari, delegati, vëzhguesi i referimit i cili në stadium fyen ose ofendon shikuesit, funksionarët e organizatës së futbollit, klubin ose anëtarët e futbollit, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi, delegimi, vëzhgimi në kohëzgjatje prej 2 deri në 6 muaj,

Sulmi fizik i gjyqtarëve ndaj punëtorëve sportive dhe shiquesëve, do të dënohet:

- b) me ndalesë të referimit në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 1 vitë,
- c) për tentim do të dënohet.

Neni 87

Gjyqtari, delegati apo vëzhguesi i referimit të ndeshjes i cili pa arsye nuk i përgjigjet ftesës së organeve të organizatave të futbollit, do të dënohet:

- a) me ndalesë referimi deri në 3 muaj.

Neni 88

Gjyqtari, delegati apo kontrollori i referimit i cili pengon zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj tij apo të tjerëve, qoftë me mospërgjigje në ftesën për marrjen në pyetje, qoftë në mënyrë tjetër, do të dënohet:

- b) me ndalesë referimi në kohëzgjatje prej 6 muaj deri në 1 vitë.

Neni 89

Gjyqtari i cili referon ndeshjen gjatë kohës kur është i suspenduar ose i dënuar, do të dënohet:

- c) me ndalesë referimi, prej 6 muaj deri në 1 vitë.

Neni 90

Përrjashtimi i delegatit, gjyqtarit dhe vëzhguesit të referimit nga organizata e futbollit pason, nëse gjyqtari, delegati dhe vëzhguesi referimit:

- d) nuk i pranon dispozitat e Statutit dhe të akteve tjera normative të FFK-së, dhe organeve të sajë,
- e) gjatë kryerjes së detyrës së vetë sportive merr dhurata të caktuara apo shuma të të hollave që nuk parashihen me dispozita ligjore,
- f) kryen vepër penale të vjedhjes, shpërdorimit apo plaçkitjes,
- g) për shkak të interesit personal delegon, referon, vëzhgon në mënyrë të njëanshme apo nxitë tjetrin për një gjë të tillë,
- h) është i dhanur përtej mase për konsumimin e alkoholit apo mjeteve të tjera dehëse,
- i) në vazhdimësi kryen kundërvajtje për të cilat shqiptohen dënime kohore prej 6 e më shumë muajve.

IV.PROCEDURA DISIPLINORE

IV/1. Organet disiplinore

Neni 91

Procedurën e fillojmë dhe dënimet i shqiptojnë organet disiplinore kompetente të Federatës së Futbollit të Kosovës, respektivisht të subjekteve që udhëheqin me garat në rangun më të ulët (liga e IV).

Udhëheqësitë e organizatave të futbollit, me vendim të posaçëm mund të caktojnë, që për llojet e caktuara të kundërvajtjeve dhe dënime deri në lartësi të caktuar, në vendë të organit kolektiv, do të vendos organi individual disiplinor.

Subjektet që udhëheqin me gara të rangut më të ulët, mund të nxjerrin dispozita të posaçme mbi zhvillimin e procedurës disiplinore, të cilat mundë të jenë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore dhe aktet tjera normative. Nëse ato nuk i nxjerrin, atëherë do t'i zbatojnë dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 92

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i FFK-së, është kompetent që në shkallë të parë të vendos mbi të gjitha kundërvajtjet që mund t'i kryejnë:

- a) anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, dhe anëtarët e organeve të KE të FFK-së,
- b) lojtarët funksionarët, ekspertët dhe udhëheqësit teknik, klubet, kontrollorët, vëzhguesit, gjyqtarët dhe trajnerët në ndeshjet ndërkombëtare, dhe në ndeshjet e ligave gjegjëse që zhvillohen në kuadër të garave të udhëhequra apo të lejuara nga organet e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, dhe ndeshjet e të gjitha reprezentacioneve të futbollit të Kosovës,
- c) klubet lidhur me afarizmin materialo-financiar kur është fjala për obligimet e tyre ndaj FFK-së,

- d) lojtarët, funksionarët, klubet dhe udhëheqësit e FFK-së, dhe subjektet që udhëheqin me gara në rangun më të ulët, kur është fjala për kundërvajtje lidhur me dispozitat mbi regjistrimin e lojtarëve për klubet e rangjeve gjegjësetë garave, apo për klubet e huaja ose lojtarët që kalojnë prej një klubi të një grupi të ligës së katërt në klubin e grupit tjetër të rangut të njejtë.

Kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe të Etikës të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, mund të paraqitet ankesë komisionit për ankesa (shkalla e dytë) të FFK-së.

IV/2. Subjektet që udhëheqin me gara në rangun më të ulët

Neni 93

Komisioni Disiplinor dhe i Etikës i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, që udhëheqin me gara në rangun më të ulët, është kompetent të vendosë në shkallë të parë mbi të gjitha kundërvajtjet që i kanë kryer:

- a) anëtarët e KE dhe të organeve të KE të subjektit që udhëheq me gara,
- b) lojtarët, funksionarët, udhëheqësit teknik dhe profesional, klubet, gjyqtarët dhe trajnerët përveç për kundërvajtjet për të cilat janë kompetente organet nga neni 84 i kësaj rregullore,
- c) klubet, lidhur me afarizmin materialo-financiar, kur është fjala për obligimet e tyre ndaj subjektit që udhëheq me gara në rangun më të ulët.

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor dhe të Etikës të subjektit që udhëheq me gara në rangun më të ulët, të marrë në shkallë të parë, mund të paraqitet ankesa komisionit për ankesa (shkalla e dytë) kryesisë të rangut më të ulët, eventualisht vetë kryesisë, nëse ai nuk parashihet me dispozitat e veta komisionin për ankesa respektivisht organin tjetër të ngjajshëm.

IV/3. KLUBET

Neni 94

Organi disiplinor i klubit, u shqipton dënime anëtarëve të klubit për kundërvajtje të kryera ndaj klubit. Dënimet me ndalesë loje dhe ndalesë të kryerjes së funksionit të shqiptuara nga ana e organit disiplinor të klubit, nuk mund të jenë më të larta se 6 muaj, përveç dënimit me përjashtim nga klubi. Nëse nuk janë të vërtetuara nga ana e organit kompetent disiplinor të forumit të caktuar sipas nenit 38 (ish 35) të kësaj rregullore, dënimet që i ka shqiptuar organi i klubit, vlejnjë vetëm në suaza të klubit. Kundër vendimit të organit disiplinor të klubit të marrë në shkallë të parë, mund t'i paraqitet ankesa kryesisë së klubit.

IV/4. Përbërja e organit Disiplinor

Neni 95

Organet disiplinore përbëhen prej 3 deri në 5 anëtarë, nëse me dispozita të posaçme nuk është rregulluar ndryshe.

IV/5. Vendosja

Neni 96

Për të qenë vendimet meritore të organeve disiplinore, në seancat e tyre duhet të punojnë dhe vendosin me shumicën e anëtarëve.

Organet disiplinore mbajnë seancat e rregullta të tyre, në ditët e caktuara të javës.

Anëtari i organit disiplinor i cili ka marrë pjesë në vendosje në shkallë të pare, nuk mund të vendosë për lëndë të njejtë dhe në shkallën e dytë eventualisht në mbrojtjen e ligjshmërisë apo zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

Anëtari i organit disiplinor, kur vendoset për kundërvajtjet e klubit ose anëtarit të klubit që ai i përket, përjashtohet nga diskutimi dhe vendosja për atë lëndë. Procedura është publike, përveç te vendosja mbi dënimin.

IV/6. Hapja e procedurës

Neni 97

Procedura disiplinore mund të inicohet:

- a.** me raportin e vëzhguesit.
- b.** me fletëparaqitjen e klubit.
- c.** me fletëparaqitjen e gjyqtarit.
- d.** me fletëparaqitjen e organit dhe udhëheqësisë së organizatës së futbollit.
- e.** me fletëparaqitjen e anëtarit të organit disiplinor.
- f.** sipas detyrës zyrtare, madje edhe në bazë të inçizimit të tv.

Neni 98

Fletëparaqitja i ushtrohet organit disiplinor kompetent i cili vendosë mbi hapjen e procedurës.

Neni 99

Para se të hapë procedurën disiplinore, organi disiplinor duhet të vërtetojë në mënyrë paraprake se a është kompetent të shqyrtojë dhe vendosë për këtë rast.

Nëse organi disiplinor nuk është kompetent ta shqyrtojë rastin e paraqitur, është i obliguar që lëndën t'ia dorëzoj organit disiplinor kompetent.

Neni 100

Konfliktin e kompetencës së organit disiplinor e zgjedhë organi i pare më i lartë disiplinor dhe në bazë të dispozitave të kësaj rregullore dhe të akteve tjera normative të FFK-së.

IV/7. Rrjedhja e procedurës

Neni 101

Pas vërtetimit të kompetencës së vet, organi disiplinor i fton dhe zhvillon bashkëbisedime me kryesit e kundërvajtjes (veprës) që të vendos për hapjen e procedurës disiplinore dhe për të marrë vendim formal.

Nëse i njëjti nuk jeton në vendin e selisë së organit disiplinor, prania e kryesit për bashkëbisedime rreth rastit do të bëhet përmes lutjes me ndihmën e organizatës së futbollit, apo përmes klubit të tij.

Nëse është fjala për lojtarin e përjashtuar, ky është i obliguar që t'i paraqitet vëzhguesit për të bashkëbiseduar (plotësimin e deklartës) më të përfunduar ndeshja.

Nëse për shkaqe të ndryshme nuk vepron sipas alinesë paraprake, klubi është i obliguar që lojtarin ta ftojë në bashkëbisedim dhe deklaratën e tij me shkrim ta deponoj në afat prej 48 orë (nga përfundimi i ndeshjes) t'ia dorëzoj organit kompetent disiplinor.

Nëse lojtari dhe klubi nuk veprojnë sipas alineve paraprake, konsiderohet se është trajtuar rasti dhe organi disiplinor kompetent do të vendosë, se a do të inicon procedurën për shkeljen apo jo.

Neni 102

Procedura disiplinore duhet të jetë e shpejtë dhe ekonomike. Procedura disiplinore e shkallës së parë, duhet të përfundoj më së largu brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh nga dita e shqyrtimit. Nëse në këtë afat nuk ka përfunduar procedura, konsiderohet se fletëparaqitja është refuzuar, ndërsa ushtruesi i fletëparaqitjes ka të drejtë ankese organit të shkallës së dytë.

Neni 103

Procedura disiplinore, marrja në bashkëbisedim e kryesëve të kundërvajtjes (veprës), dëshmitarëve dhe mbledhja e fakteve tjera provuese, kryhet nga ana e anëtarëve të caktuar të organit disiplinor dhe nga organet tjera (komisionet e garave) të FFK-së, të cilat luten për ndihmën e tillë.

Kryesi i kundërvajtjes (veprës) ka të drejtë të kërkojë që të ftohet në shpenzime personale në seancën e organit disiplinor për sqarime më të hollësishme, respektivisht për tu dëgjuar apo për t'ju përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga organi disiplinor.

Neni 104

Në rastet e komplikua, nëse organi disiplinor e sheh si të domosdoshme mund të ftojë edhe ekspertë (përfaqësues të gjyqtarëve dhe trajnerëve etj...) për t'i konsultuar ata për qëstje profesionale dhe në atë mënyrë mund të marr vendim sa më të drejtë dhe objektiv.

IV/8 Vërtetimi i fakteve

Neni 105

Organet disiplinore vendimet e veta si dhe dënimet e shqiptuara, duhet t'i bazojë në provat e mbledhura dhe mendimet e siguruar të personave zyrtarë dhe organeve të FFK-së, pjestarëve të organeve të Ministrisë së Rendit Publik, inçizimeve televizive si dhe nga vrojtimi i drejtëpërdrejtë. Si prova mund të merren edhe deklaratat e dhëna para organeve tjera.

IV/9. Pezullimi i procedures

Neni 106

Kur organi disiplinor vërteton se nuk ka vendë për hapjen e procedures disiplinore, me vendimin e vet e hedh poshtë fletëparaqitjen e deponuar, ndërsa nëse organi disiplinor ka hapur procedurë disiplinore, por paraqiten rrethana të cilat tregojnë se nuk ka vendë për procedurën disiplinore, organi disiplinor e pezullon procedurën.

Ndaj vendimit të organit disiplinor hüdhen poshtë të fletëparaqitjes, respektivisht pezullimin e procedures, ushtruesi i fletëparaqitjes ka të drejtë ankese tek Komisioni për ankese i FFK-së, respektivisht organeve që parashihen në nenin 85 alinea e fundit e kësaj rregullore.

IV/10 Shpenzimet e procedurës

Neni 107

Nëse gjatë procedures disiplinore janë shkaktuar shpenzime, organi disiplinor kompetent do të vendos se kush është i organizuar t'i paguaj ato.

Për ndërmarrjen e veprimeve të cilat shkaktojnë shpenzime në procedurën disiplinore, organi disiplinor kompetent, në mënyrë praktike duhet të marrë vendimin gjegjës.

Nëse klubi ose anëtarët e klubit kundër të cilëve është zhvilluar procedura, janë liruar nga përgjegjësia disiplinore, shpenzimet e procedures bien në barrë të buxhetit të udhëheqësisë, organi i së cilës ka nxjerrë vendim.

Nëse klubi ose anëtari i klubit kundër të cilave është ushtruar procedura disiplinore dënohen, atëherë shpenzimet e procedures bien në barrë të buxhetit të klubit.

Në raste të arësyeshme, nëse shpenzimet e procedures disiplinore të shkaktuara jo me fajin e klubit, organi kompetent disiplinor mund të vendosë që shpenzimet e procedures që bien mbi barrën e atij organi respektivisht të udhëheqësisë së atij organi.

IV/11 Suspendimi

Neni 108

Suspendimi mund të jetë:

- a. i menjëhershëm (automatik) dhe
- b. në bazë të Vendimit të organit disiplinor.

Neni 109

Suspendimi i menjëhershëm, paraqitet kur lojtari përjashtohet nga loja në ndeshjet publike, përveç në ndeshjet ndërkombëtare të cilat luhen në kuadër të garave të FIFA-së, UEFA-së, dhe organizatave tjera ndërkombëtare. Për këto përjashtime vlejnë dispozitat e këtyre organizatave.

Suspendimi i menjëhershëm i paraqitur me përjashtimin e lojtarit në ndeshje miqësore pushon menjëherë në ditën kur lojtari i përjashtuar nga loja i jep deklaratën me shkrim organit disiplinor kompetent dhe hapet procedura disiplinore ndaj tij sipas dispozitave të kësaj rregullore.

Organi disiplinor mund të bjerë vendimin mbi heqjen e suspendimit të menjëhershëm, nëse konstaton se nuk ka nevojë për një gjë të tillë. Kohëzgjatjen e suspendimit të menjëhershëm Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, mund ta caktojë në Propozicionet e Garave apo me ndonjë vendim të posaçëm.

Lojtari i cili gjendet në vuajtje (ekzekutim) të sanksionit penal, në ndonjë shtëpi edukativo-korektuese, është nën suspendim të menjëhershëm i cili zgjatë tërë kohën sa ai do të jetë në vuajtje të dënimit respektivisht të sanksionit penal. Suspendimi i menjëhershëm, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Neni 110

Nëse klubi, lojtari, funksionari, udhëheqësi professional apo teknik në afatin e paraparë që i cakton organi kompetent nuk e paguan dënimin e caktuar në të holla ose nuk e përmbush obligimin ndaj klubit apo forumit tjetër, i cili obligim është shkaktuar në marrëdhënjet sportive, do të suspendohet në bazë të vendimit të organit disiplinor dhe kundër tij do të zhvillohet procedura disiplinore.

Suspendimi fillon nga dita e fundit e afatit të dhënë për pagimin e dënimit në të holla apo përmbushjes së obligimit.

Suspendimi shqiptuar me vendimin e organit kompetent, hiqet (pezullohet):

- a. me vendimin e organit disiplinor, pasi të vërtetohet se ka pushuar arësya për suspendim, dhe
- b. menjëherë pas përmbushjes (pagesës) së tërësishme të shumës së të hollave të theksuar në dënimin apo përmbushjes së obligimit i cili e ka shkaktuar suspendimin.

Neni 111

Suspendimi më vendimin e organit kompetent disiplinor mund t'iu shqiptohet; lojtarëve, funksionarëve, udhëheqësve professional dhe teknik, gjyqtarëve dhe trajnerëve në të gjitha rastet kur kanë kryer kundërvajtje për të cilat parashihen dënime të rënda. Nëse marrja në pyetje nuk është kryer në afat prej tetë (8) ditësh, suspendimi mund të vazhdohet edhe për një muaj.

Neni 112

Suspendimi i shqiptuar për shkak se personi i caktuar nuk iu ka paraqitur organit kompetent për të marrë në pyetje, pushon në ditën kur i ftuari i paraqitet organit kompetent të FFK-së, për të marrë në pyetje.

Nëse kryesi i kundërvajtjes edhe pas ftesës të dytë nuk i paraqitet organit për marrje në pyetje edhe nga kjo ftesë kalojnë 8 ditë, do t'iu shqiptohet dënimi në bazë të shkresave (provave) që disponon organi disiplinor.

IV/12 Vendimet e organeve disiplinore

Neni 113

Shqiptimi i çdo vendimi mbi dënim, duhet të shpallet (publikohet) përmes Buletinit Zyrtarë, në të cilin shënohet saktësisht se prej cilës ditë fillon të rrjedh dënimi.

Në vendimin e organit disiplinor duhet shënuar, përbërjen e organit i cili merrë vendimin, personin (lojtari, klubi etj.) të cilit i shqiptohet dënimi, përshkrimi i kundërvajtjes, lloji i kundërvajtjes, lloji dhe lartësia e dënimit, arsyetimi dhe udhëzimi mbi mjetet juridike.

Neni 114

Organi kompetent disiplinor, është i obliguar që për ç'do dënim të shiptuar, ta njoftoi me shkrim (letër apo telegram) klubin, apo lojtarin e dënuar dhe atë më së largu në afat prej 48 orëve nga dita e shqiptimit të dënimit.

Vendimi mbi dënimin, duhet t'i komunikohet klubit, më së voni 48 orë para zhvillimit të ndeshjes së parë e cila përfshihet në dënim. Vendimet do t'u përcillen klubeve edhe nëpërmjet fax-it, dhe e-mail-it zyrtar të klubit, dhe do të publikohen edhe në bultenin zyrtar të FFK-së.

Dënimi rrjedhë nga dita e komunikimit që i bëhet klubit, nëse lojtari i dënuar ka qenë nën suspendim, dënimi rrjedhë nga dita e komunikimit të suspendimit të klubit, respektivisht nga dita kur është paraqitur suspendimi i menjëhershëm. Organi disiplinor i shkallës së parë sipas detyrës zyrtare është i obliguar që të përcjellë ekzekutimin e dënimit.

Neni 115

Nëse në Statut ose në aktë tjetër të përgjithshëm të FFK-së, respektivisht të subjektit që udhëheq me gara në rang të ulët, nuk parashihet mënyrë tjetër e komunikimit dhe shpalljes së vendimeve, organi disiplinor përmes personelit administrative gjegjës, është i obliguar që vendimin me arsyetim t'ia dorëzoj personit të dënuar, respektivisht klubit dhe ushtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 8 ditësh nga dita e shqiptimit të dënimit.

Neni 116

Komisioni i Ankesave (organi i shkallës së dytë)

Komisioni i Ankesave është organ vendimarrës dhe i pavarur i cili zgjedhet nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së dhe vepron në përputhje me aktet normative të FFK-së dhe legjislaconi përkatës në fuqi.

Komisioni i Ankesave përbëhet nga tre [3] anetare ku njëri prej tyre është kryesues.

Komisioni i Ankesave ka kuorum kur janë të pranishëm të gjithë anetarët e komisionit.

Vendimet e Komisionit të Ankesave merren me shumicë të votave të anetareve të komisionit.

Komisioni i Ankesave është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor dhe të Etikës që nuk janë shpallur përfundimtare nga rregulloret përkatëse të FFK-së.

Vendimet e shpallura nga Komisioni i Ankesave mund t'i drejtohen vetëm një gjykatë/organ arbitrazhi sportiv të pavarur dhe të formuar në mënyrë të rregullt në përputhje me dispozitat e Statutit.

Neni 117

Kundër vendimit të organit disiplinor të shkallës së parë, mund të paraqitet ankesa ne Komisionin e Ankesave, në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimin të vendimit, përmes organit të shkallës së parë.

Në procedurën sipas ankesës organi i shkallës së parë, e vërteton se a i plotëson kushtet formale ankesa, a është e ushtruar në afatin e paraparë, a është taksuar, a është e ushtruar nga personi i autorizuar dhe a është e lejuar.

Pasi t'i vërteton të gjitha faktet e përmendura në alinen paraprake, në afat prej 3 ditëve, tërë lëndën ia dorëzon për shqyrtim dhe vendosje të Komisionit për ankesa të shkallës së dytë.

Ankesa e ushtruar jashtë afatit të paraparë, e pa lejuar dhe e ushtruar për persona të paautorizuar, hudhet poshtë me vendim të caktuar.

Ankesat e pa taksuara dhe të pa kompletuara, i këthehen ushtruesit të saj në plotësim, përmirësim ose pagesë të taksës, duke i caktuar afatin e shkurtër për plotësim.

Nëse në afatin e dhënë nuk evitohen (plotësohen) këto të meta, ankesa hudhet poshtë me vendim të caktuar. Kundër vendimit mbi hudhjen poshtë të ankesës së pa lejueshme dhe të ushtruar pas kalimit të afatit, ushtruesi i ankesës, ka të drejtë ankese, për të cilën do të vendosë organi kompetent i shkallës së dytë.

Ankesa nuk është e lejuar kundër vendimit mbi suspendim.

IV/13

Neni 118

Ankesën mund ta ushtrojnë:

- a. Të dënuarit.
- b. Ushtruesit të raportit apo fletëparaqitjes.
- c. Klubi, anëtari i të cilit është i dënuari.
- d. Organizata, anëtari i të cilit është i dënuari.

Neni 119

Ankesa kundër vendimit mbi dënimin, nuk e stopon (ndalon) ekzekutimin e dënimit mbi ndalesën e lojës respektivisht ushtrimin të detyrës (funksionit) në organizatën e futbollit.

Neni 120

Duke e vendosur ankesën e ushtruar, organi disiplinor (Komisioni i Ankesave) i shkallës së dytë, ka mundësi që vendimin e organit disiplinor të shkallës së parë, ta:

- a. Vërteton.
- b. Prishë.
- c. Ndryshon.

Organi disiplinor i shkallës së dytë, do të vërtetoj vendimin e organit disiplinor të shkallës së parë, kur konstaton se organi i shkallës së parë, ka zbatuar drejtë dhe me përpikëri dispozitat juridike mbi kundërvajtjet disiplinore.

Organi disiplinor i shkallës së dytë, do ta prishë vendimin mbi kundërvajtjen disiplinore, kur konstaton se atë e ka marrë organi disiplinor jokompetent dhe lëndën do t'ia dorëzoj organit disiplinor.

Me rastin e ushtrimit të ankesës, organi disiplinor i shkallës së dytë, mund drejtëpërdrejtë apo me lutje përmes organit tjetër, të bëjë plotësimin e procedurës.

Organi disiplinor i shkallës së dytë, do ta prishë vendimin e shkallës së parë, nëse konstaton se është e nevojshme të plotësohet procedura ose të zbatohet procedura e re, duke ia këthyer të gjitha shkresat e lëndës organit disiplinor të shkallës së parë, që ky të marrë vendim tjetër.

Organi disiplinor i shkallës së parë, të cilit i është këthyer lënda, është i obliguar që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për plotësimin e procedurës, sipas direktivave të organit të shkallës së dytë.

Organi disiplinor i shkallës së dytë, mund të ndryshoi vendimin e organit disiplinor të shkallës së parë, për shkakë të vlerësimit (kualifikimit) të gabuar juridik të veprës së kundërvajtjes, për shkakë të llojit dhe të lartësisë së dënimit ose nëse vërtetohet se vepra e të pandehurit nuk i ka veçorit e kundërvajtjes disiplinore për ç'farë arsyes duhet të pezullohet procedura për kundërvajtje.

Kur ankesën e ushtron i dënuari, vendimi i organit disiplinor të shkallës së parë mbi kundërvajtjen disiplinore nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Në procedurë disiplinore të shkallës së dytë, nuk do të vlerësohen provat e as faktet e vërtetuara të cilat nuk janë theksuar në procedurën e shkallës së parë. Vendimi i shkallës së dytë duhet të mirret më së largu në afat prej 8 ditëve nga dita e protokollimit të ankesës

Nëse procedura disiplinore e shkallës së dytë, nuk përfundon në afatin e paraparë, konsiderohet se ankesa nuk është aprovuar, respektivisht vendimi i organit disiplinor të shkallës së parë, është bërë i plotëfuqishëm.

Nëse organi i shkallës së dytë nuk vepron në kuptim të alinesë së mëparme të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë që pas 15 ditëve nga dita e protokollimit të ankesës t'i drejtohet Komitetit Ekzekutiv) KE për mbrojtjen e Rregullorës, duke konsideruar se nuk është aprovuar ankesa.

Komiteti Ekzekutiv duhet që të merr Vendim për çështjen më së largu 30 ditë nga ushtrimi i kërkesës për mbrojtje të Ligjshmërisë. Ndaj vendimit të KE apo mosmarrjes së Vendimit me kohë nga ana e KE-së, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Arbitrazhit sportiv të KOK-ut, jo më larg se 60 ditë nga dita e protokollimit të kërkesës në KE.

Neni 121

Nëse Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, e vërteton në çfarëdo mënyre se organet kompetente për zbatimin e kësaj rregullore, nuk i kanë përfillur dispozitat e kësaj rregullore si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural gjatë vendosjes mbi qështjet e caktuara disiplinore në garat e futbollit.

Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë që sipas detyrës zyrtare të marrë vendimin definitive mbi atë qështje (madje edhe nëse vendimi i organeve disiplinore është bërë i plotëfuqishëm), kurse ndaj organeve të

tilla të inicoj procedurën disiplinore dhe të kërkoj apo të shqiptoj masat konkrete të parapara me aktet normative të FFK-së.

Ndaj Vendimit të Komitetit Ekzekutiv (ose mos marrjes të ndonjë vendimi pas afatit prej 30 ditësh), pala e pakënaqur mundet t'i drejtohet Arbitrazhit Sportiv, ne Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë CAS.

V. PËRSËRITJA E PROCEDURËS

Neni 122

Deri te përsëritja e procedures mund të vijë:

- a) nëse vërtetohet se vendimi i plotëfuqishëm i organeve disiplinore është bazuar në dokumente të rrejshme.
- b) nëse ekzistojnë fakte dhe prova të reja të cilat do të ishin të rëndësishme së posaçme në marrjen e vendimit, e për të cilat, organi i cili e ka marrë vendimin më parë, nuk ka pasue e as që ka pasur mundësi të ketë njohuri.

Neni 123

Propozimin për përsëritjen e procedurës, mund ta ushtrojnë personat dhe organet e precizuara me nenin 114 të kësaj rregullore.

Neni 124

Propozimi për përsëritjen e procedures i paraqitet:

- a) Komitetit Ekzekutiv të subjektit i cili udhëheq me gara në rangun më të ulët përmes organit i cili ka marrë vendimin, nëse është fjala për vendimet e organeve disiplinore të garave të rangut më të ulët.
- b) Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, përmes organit i cili ka marrë një vendim të këtillë, nëse është fjala për vendimet e organeve disiplinore të FFK-së, (katër rangje më të larta të garave, Superliga, Liga e Parë, Dytë dhe Tretë).

Propozimi për përsëritjen e procedures, mund të ushtrohet në afat prej 1 (nje) muaji nga dita e pranimit të vendimit të plotëfuqishëm.

Neni 125

KE, i subjektit që udhëheq me gara në rangun më të ulët (Ligat rajonale), respektivisht KE, i FFK-së, nëse aprovon propozimin për përsëritjen e procedures, vetë mund të zbatoj procedure të re ose lëndën t'ia dorëzoj organit disiplinor i cili ka vendosur në shkallë të parë, për ta shqyrtuar dhe vendosur edhe njëher atë çështje. Propozimi për përsëritjen e procedurës, nuk e stopon (ndalon) vendimin për ekzekutimin e dënimit.

VI. ZBUTJA E JASHTËZAKONSHME E DËNIMIT

Neni 126

Kur ekzistojnë prova të sigurta se dënimi i shqiptuar e ka arritur qëllimin e vet edukativ, sportiv moral, ose kur janë paraqitur rrethana të reja, të njohura pas plotëfuqishmërisë së vendimit ose

rrethana të cilat kanë ekzistuar gjatë shqiptimit të dënimit por për të cilat organi disiplinor nuk ka pasur njohuri, si dhe rrethana të tjera të cilat, sipas natyrës së tyre, sikurse të merreshin parasyshë me rastin e marrjes së vendimit për denim, do të ndikonin dukshëm që ai të jetë më i butë, si për nga lloji ashtu edhe për nga lartësia, ose do të shkaktonin lirimin e kryesit nga denim, KE, i FFK-së, apo Kuvendi i FFK-së, mund të bie vendimin për zbutjen e dënimit ose lirimin nga vuajtja e mëtejshme e dënimit.

KE i FFK-së, nuk ka të drejtë të shqyrtojë lutjet e ankesat e atyre që janë të dënuar më shumë se 1 vitë (12 muaj), ndërsa për këto dënime (mbi një vjet) është kompetent Kuvendi i FFK-së.

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, ushtrohet vetëm një herë gjatë një viti garues.

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, pavarësisht nga përgjigja në kërkesën e pare, herën tjetër mund të ushtrohet në vitin e ardhshëm garues.

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, dorëzohet së paku 15 ditë para mbajtjes së Kuvendit gjegjës të FFK-së.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 127

KE i FFK-së, është i autorizuar që të japë udhëzime për zbatimin e kësaj rregullore dhe të bëjë interpretimin e dispozitave të saj.

Neni 128

Kjo rregullore është aprovuar me datë 04 Korrik 2023.

Rregullorja hyn në fuqi një ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 04 Korrik 2023

Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së,

Agim Ademi